



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.119

20 nëntor

2006

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i Kuvendit nr.64, datë 6.11.2006	Për shtyrjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore, ngritur me vendimin e Kuvendit nr.38, datë 18.5.2006.....	4765
Dekret nr.5108 datë 8.11.2006	Për emërim ambasadori.....	4765
Dekret nr.5109 datë 8.11.2006	Për lirim ambasadori.....	4765
Vendim i KM nr.733, datë 1.11.2006	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i nënstacionit 220/110/35/20 kv Koplik, Malësi e Madhe.....	4766
Vendim i KM nr.734, datë 1.11.2006	Për fillimin e procedurave për mbylljen e kontratës së koncesionit, për ndërmarrjen e ujësjellës-kanalizimeve, Elbasan, dhe lejimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të blejë 100 për qind të aksioneve të shoqërisë “Berlinwasser International, GmbH” në “Elber” sh.p.k.....	4767
Vendim i KM nr.735, datë 1.11.2006	Për disa ndryshime në vendimin nr.622, datë 12.11.2001 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e zonave, ku mund të hapen kazino”, të ndryshuar.....	4768
Udhëzim i MBUMK nr.1, datë 9.11.2006	Për zbatimin e pikës 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.148, datë 31.3.2000 “Për mënyrën e shitjes së mallrave të	4769

	ardhura grant nga Japonia në kuadër të Projektit “Rritja e prodhimit ushqimor, 2KR””.....	
Udhëzim i MPPTT nr.6, datë 8.11.2006	Për dokumentacionin tekniko-ligjor për miratimin e kufirit të zonës/vendbanimit/bllokbanimit/ndërtimit informal të veçuar dhe të territoreve të tjera me ndërtime pa leje.....	4782
Udhëzim i MPPTT nr.7, datë 8.11.2006	Për mënyrën e plotësimit dhe ruajtjen e të dhënave për ndërtimet pa leje.....	4784
Urdhër i ALUIZNI nr.8, datë 30.10.2006	Për miratimin e manualit të hartimit dhe paraqitjes së materialeve grafike.....	4788
Vendim i GJL nr.9, datë 9.3.2006	Me objekt detyrimin e palës së paditur për pagimin e shumës 61317 000 lekë.....	4796
Vendim i ERE nr.73, datë 2.11.2006	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit, për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, për shoqërinë “WTS Energji” sh.p.k., për vitin 2007.....	4806
Vendim i ERE nr.74, datë 2.11.2006	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit, për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, për shoqërinë “Amal” sh.p.k., për vitin 2007.....	4806
Vendim i ERE nr.75, datë 2.11.2006	Për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga “Juana” sh.p.k. për periudhën 1 janar 2006 deri në 31 dhjetor 2006.....	4807
Vendim i ERE nr.76, datë 7.11.2006	Për transferimin e licencës nga “Sarmier” sh.p.k. te “Projeksion” sh.p.k.....	4807
Vendim i ERE nr.77, datë 7.11.2006	Për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga “Maksi Elektrik” sh.p.k. për periudhën 1 janar 2006 - 31 dhjetor 2006.....	4808
	Ndreqje gabimi.....	4808

VENDIM
Nr.64, datë 6.11.2006

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT TË POSAÇËM
PARLAMENTAR PËR REFORMËN ZGJEDHORE, NGRITUR ME VENDIMIN E
KUVENDIT NR.38, DATË 18.5.2006**

Në mbështetje të nenit 77 pika 1 të Kushtetutës dhe të nenit 24 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi parlamentar, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

VENDOSI:

I. Afati i veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore shtyhet deri më 14 nëntor 2006.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

DEKRET
Nr.5108, datë 8.11.2006

PËR EMËRIM AMBASADORI

Në mbështetje të nenit 92, pika dh, dhe 93 të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zonja Afërdita Dalla emërohet në detyrën e Ambasadores së Jashtëzakonshme dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Danimarkës.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET
Nr.5109, datë 8.11.2006

PËR LIRIM AMBASADORI

Në mbështetje të nenit 92 pika dh të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Shaban Murati lirohet nga detyra e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Suedisë, rezident, si dhe e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Republikën e Finlandës, në Republikën e Islandës dhe në

Mbretërinë e Norvegjisë, jorezident.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

VENDIM
Nr.733, datë 1.11.2006

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I NËNSTACIONIT
220/110/35/20 KV KOPLIK, MALËSI E MADHE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i nënstacionit 220/110/35/20 kV Koplik, Malësi e Madhe, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të KESH sh.a.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 21 834 m², tokë bujqësore arë, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 18 558 900 (tetëmbëdhjetë milionë e pesëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind) lekësh.

4. Ky fond të përballohet nga fondet e KESH sh.a. zëri “Kosto vendore për shpronësimet”.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të shpronësimit të jetë në shumën 236 000 (dyqind e tridhjetë e gjashtë mijë) lekë dhe të përballohet nga KESH sh.a. si subjekti kërkues i këtij shpronësimi.

6. Shpronësimi të fillojë brenda muajit nëntor 2006 dhe të përfundojë brenda muajit dhjetor 2006.

7. Punimet për ndërtimin e këtij nënstacioni të fillojnë brenda muajit nëntor 2006 dhe të përfundojnë brenda vitit 2007.

8. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe KESH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES

LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN PER EFEKT TE "NDERTIMIT TE NENSTACIONIT 220/110/35/20 KV KOPLIK, MALESI E MADHE".

QARKU : SHKODER
RRETHI : MALESI E MADHE
KOMUNA: QENDER KOPLIK

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet : "Tokë bujqësore Arë".

Nr	Të dhënat e pasurisë së paluajtshme "Tokë arë", që shpronësohet								Adresa e pasurisë
	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona Kadastrale	Numri i pasurisë	Sip. në m ² , e tokës që zë nënstationin	Cmimi lekë/m ²	Vlera totale e kompesimit në lekë	
1	Skender	Musli	Delishaj	1238	28	1192	850	1 013 200	Bogic-Palvar
2	Enver	Muhamet	Zeka	1238	17	6702	850	5 696 700	Bogic-Palvar
3	Muhamet	Ymer	Zeka	1238	16	1123	850	954 550	Bogic-Palvar
4	Sami	Xhelal	Zekaj	1238	18	4745	850	4 033 250	Bogic-Palvar
5	Jonuz	Riza	Delishaj	1238	15/1	2272	850	1 931 200	Bogic-Palvar
6	Sami	Xhelal	Zekaj	1238	15/2	5800	850	4 930 000	Bogic-Palvar
/			Totali	---	---	21 834	----	18 558 900	

Sqarime: Shpenzime procedurale: Publikime 180 000 (njëqindetëdhjetëmijë) lekë.
Shpërbim i anëtarëve të komisionit të posaçëm dhe sekretarisë teknike 56 000 (pesëdhjetëegjashëmijë) lekë.

Vlera totale e shpronësimit = 18 558 900 + 180 000 + 56 000 = 18 794 900 lekë.

VENDIM
Nr.734, datë 1.11.2006

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MBYLLJEN E KONTRATËS SË KONCESIONIT, PËR NDËRMARRJEN E UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE, ELBASAN, DHE LEJIMIN E MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS TË BLEJË 100 PËR QIND TË AKSIONEVE TË SHOQËRISË "BERLINWASSER INTERNATIONAL, GmbH" NË "ELBER" SHPK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", të ndryshuar, të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë" dhe të ligjit nr.8783, datë 7.5.2001 "Për miratimin e marrëveshjes së koncesionit të formës "Bot", ndërmjet Ministrisë së Punëve Publike, Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, bashkisë së qytetit të Elbasanit dhe "Berlinwasser International, GmbH", për ndërmarrjen e ujësjellësit dhe ujë-kanalizimeve Elbasan, si dhe dhënien e disa stimuljeve dhe garancive për koncesionarin e kësaj Marrëveshjeje", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për mbylljen e kontratës së koncesionit, të nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Punëve Publike, Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, bashkisë së qytetit të Elbasanit dhe shoqërisë "Berlinwasser International GmbH" për ndërmarrjen e ujësjellës-kanalizimeve Elbasan.

2. Lejimin e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të blejë 100 për qind të aksioneve të shoqërisë "Berlinwasser International, GmbH" në "Elber" sh.p.k. (ndërmarrja e ujësjellës-kanalizimeve të qytetit të Elbasanit), me vlerë 10 000 (dhjetë mijë) lekë.

3. Fondi për blerjen e këtyre aksioneve të përballohet nga buxheti i vitit 2006, zëri "Shpenzime operative", miratuar për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

4. Ngritjen e grupit të punës, me përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për negocimin, me shoqërinë “Berlinwasser International GmbH”, të kushteve, teknike e juridike, të kontratës së shitblerjes së këtyre aksioneve.

5. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për përgatitjen e ndryshimeve të nevojshme tekniko-juridike dhe të autorizimeve përkatëse për realizimin e procedurave.

6. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.735, datë 1.11.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.622, DATË 12.11.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E ZONAVE, KU MUND TË HAPEN KAZINO”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 13 të ligjit nr.8701, datë 1.12.2000 “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.622, datë 12.11.2001 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1. Kudo në vendim emërtimi “Ministria e Financave” zëvendësohet me “Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës”.

2. Kudo në vendim emërtimi “Ministria e Rendit Publik” zëvendësohet me “Ministria e Brendshme”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.1, datë 9.11.2006

PËR ZBATIMIN E PIKËS 4 TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.148, DATË 31.3.2000 “PËR MËNYRËN E SHITJES SË MALLRAVE TË ARDHURA GRANT NGA JAPONIA NË KUADËR TË PROJEKTIT “RRITJA E PRODHIMIT USHQIMOR,

2KR””

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, të ligjit nr.7971, datë 26.5.1995 “Për prokurimin publik”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.192, datë 20.3.1998 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet dhe procedurat e shitjes”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.452, datë 1.7.1998 “Për disa masa për përmirësimin e punës për zbatimin e projekteve që financohen nga donatorët e huaj”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.299, datë 24.6.1999 “Për miratimin e grantit dhënë nga Qeveria e Japonisë për përballimin e situatës së krijuar për shkak të krizës në Kosovë”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.7, datë 13.1.2000 “Për masat dhe mënyrën e zbatimit të Projektit “Rritja e prodhimit ushqimor, 2KR””, financim falas i Qeverisë së Japonisë dhe të pikës 2.1 dhe 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.148, datë 31.3.2000, shtuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.105, datë 18.2.2005 “Për mënyrën e shitjes së mallrave të ardhura grant nga Japonia në kuadër të Projektit “Rritja e prodhimit ushqimor, 2KR””, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.96, datë 2.3.2001 “Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë Japoneze, për financimin e Projektit “Rritja e prodhimit ushqimor, 2KR” në Shqipëri”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.600, datë 2.11.2001 “Për mënyrën e shitjes së mallrave të ardhura grant nga Qeveria e Japonisë në kuadër të projektit II “Rritja e prodhimit ushqimor, 2KR”” dhe për miratimin e fondeve buxhetore për realizimin e këtij Projekti, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.76, datë 14.3.2002 “Për miratimin, në parim, të marrëveshjes, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Japonisë, për financimin e Projektit “Për rritjen e prodhimit ushqimor, 2KR 2001” në Shqipëri”,

UDHËZOJ:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Shitja e mallrave të ardhura grant nga Qeveria e Japonisë për Projektin "Rritja e prodhimit ushqimor, 2KR" bëhet me ankand.
2. Ankandi bëhet i hapur për çdo mall.
3. Procedura e shitjes duhet të garantojë të drejtën e konkurrencës së lirë e të barabartë, duke mos lejuar diskriminim të konkurrentëve, administrimin e mirë dhe rigoroz të mallit të vënë në dispozicion.
4. Gjatë procesit të zbatimit të këtij udhëzimi të ruhen disa prej principeve bazë të Projektit, si:
 - a) Të kontribuojë në rritjen e prodhimit ushqimor nëpërmjet shpërndarjes së donacioneve në mënyrë transparente në përputhje me qëllimin e dhënies së tij.
 - b) Të bashkëpunojë e koordinojë veprimtarinë me strukturat shtetërore dhe private për kthimin e fondit kundërparti në afatet e parashikuara në marrëveshjet me donatorin.
 - c) Të sigurohet një vijueshmëri në disbursimin e fondeve grant të donatorit në kuadrin e Projektit “Rritja e prodhimit ushqimor, 2KR”.

KREU II AUTORITETI PËRGJEGJËS

1. Përgatitja dhe zhvillimi i ankandit në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi është përgjegjësi e Projektit 2KR.
2. Njësia e menaxhimit të Projektit “Rritja e prodhimit ushqimor, 2KR” është autoriteti përgjegjës, i cili organizon, drejton dhe raporton, sipas dispozitave ligjore e nënligjore në fuqi dhe marrëveshjet ndërkombëtare, për të gjithë veprimtarinë e Projektit në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.452, datë 1.7.1998 “Për disa masa për përmirësimin e punës për zbatimin e projekteve që financohen nga donatorët e huaj”. Pas nënshkrimit të kontratave me furnizuesin ndjek

zbatimin e tyre në të gjitha hallkat. Me mbërritjen e mallrave në Republikën e Shqipërisë organizon punën për transportimin, kolaudimin dhe magazinimin e tyre, me mjete dhe në ambiente të specializuara të sektorit privat, përzgjedhja e të cilave bëhet në përputhje me ligjin nr.7971, datë 26.5.1995 “Për prokurimin publik”, me ndryshimet përkatëse dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij.

3. Për marrjen në dorëzim të mallrave, drejtori i Projektit “Rritja e prodhimit ushqimor, 2KR” ngre një komision të përbërë nga jo më pak se 5 specialistë, të cilët kanë për detyrë:

a) Të marrin në dorëzim mallin nga prurësi në portin ose pikën doganore ku kanë mbërritur mallrat, duke bërë zhdoganimin e tyre.

b) Të realizojë kolaudimin dhe dorëzimin e mallrave në magazinat e përcaktuara nga Projekti “Rritja e prodhimit ushqimor, 2KR”.

c) Të përpilojnë dhe të dorëzojnë në arkivin e Projektit 2KR të gjithë dokumentacionin bazë për magazinimin dhe shitjen e mallrave, duke bërë grupimin e mallrave në lote.

KREU III PËRGATITJA E ANKANDIT

1. Data, vendi dhe ora e zhvillimit të ankandit përcaktohen me urdhër të drejtorit të Projektit 2KR. Në të njëjtin urdhër përcaktohet përbërja e komisionit të llogaritjes së vlerës së fillimit të ankandit, komisionit të përgatitjes së dokumenteve dhe i zhvillimit të tij që do të quhet komisioni i ankandit.

2. Komisioni për llogaritjen e vlerës së fillimit të ankandit, i përbërë nga 1 kryetar dhe 2 anëtarë, ku një anëtar është përfaqësues i Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, një anëtar është përfaqësues i Projektit 2KR dhe një anëtar është specialist i fushës nga institucione shtetërore ose private. Komisioni propozohet nga drejtori i Projektit “Rritja e prodhimit ushqimor, 2KR” dhe miratohet nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

3. Drejtori i Projektit “Rritja e prodhimit ushqimor, 2KR” i propozon Ministrin të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit përbërjen e komisionit të ankandit, të përbërë nga 5 specialistë, 1 kryetar dhe 4 anëtarë, nga të cilët një jurist, ku një anëtar propozohet nga Ministria e Financave dhe një nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit. Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit miraton komisionin e ankandit.

4. Komisioni i ankandit për shitje të mallrave ka për detyrë:

a) Të hartojë dokumentacionin e nevojshëm për zhvillimin e ankandit (njoftimin për ankand, specifikimet teknike të mallrave, kërkesat për kualifikim, dokumentet për pjesëmarrësit).

b) Të verifikojë dhe evidentojë të gjithë aplikuesit për pjesëmarrje në ankand.

c) Të deklarojë vleftën fillestare të ankandit.

d) Hapi i çmimit të ankandit.

e) Të shqyrtojë dokumentacionin e paraqitur nga pjesëmarrësit.

f) Të deklarojë që fituesi i ankandit shpallet pjesëmarrësi që ofron çmimin më të lartë.

g) Të sigurojë që dhënia e ofertave të vazhdojë derisa të ketë oferta të tjera përpara shpalljes së fituesit.

4. Të mbajë procesverbalin e ankandit, në të cilin duhet të jenë të pasqyruara përbërja e komisionit, pjesëmarrësit, dokumentacionin e paraqitur, kërkesat e tyre, si dhe çmimet e ofruara. Procesverbali i ankandit është i detyrueshëm për t’u firmosur nga të gjithë anëtarët e komisionit.

5. Vlera minimale e shitjes me ankand për çdo mall është vlera e kostos së mallit, çmimi FOB, plus TVSH, plus taksa doganore dhe shpenzime të tjera operative.

KREU IV ZHVILLIMI I ANKANDIT

1. Ankandi do të zhvillohet në dy faza: Faza e parë është faza e zhvillimit të ankandit për shitje të mallrave me lekë në dorë, faza e dytë është faza e shitjes së mallrave me këste. Fillimisht do të zhvillohen dy ankande të njëpasnjëshme për shitjen direkte të mallrave, ndërsa ankandet e tjera do të jenë për shitjen e mallrave me këste me interes zero, afati i të cilave nuk mund t’i kalojë asaj të

përcaktuar në marrëveshje me donatorët.

2. Publikimi për shitje me ankand bëhet 2 herë radhazi në Buletin e Prokurimeve Publike. Dita e zhvillimit të ankandit të jetë jo më pak se 10 ditë nga dita e njoftimit të parë. Në publikim do të përcaktohen kriteret dhe kërkesat për pjesëmarrjen në ankand, vendin, datën dhe orën e zhvillimit të ankandit, sasinë, emërtimin dhe vendndodhjen e mallrave, si dhe vlerën fillestare të ankandit, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.176, datë 29.3.2006 "Për botimin e Buletinit të Njoftimeve Publike".

3. Pjesëmarrësit në ankand duhet të paraqesin në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të shitjes së mallrave këto dokumente:

- Për shitjet direkt të mallrave:

a) Dokumentin e identitetit.

b) Kërkesën për mallrat që kërkon të blejë.

c) Garancinë bankare; kjo të bëhet vetëm në bankë, që vërteton ngurtësimin për llogari të Projektit 2KR të 10 % të vleftës fillestare për mallrat që kërkon të blejë në ankand, dhe jo nga shoqëritë e sigurimeve, detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave.

d) Aktmarrëveshje paraprake e firmosur midis Projektit 2KR dhe pjesëmarrësit në ankand, me qëllim shitjen e mallrave të fituara me ankand në rrethet e përcaktuara sipas studimit dhe në marrëveshje me Qeverinë e Japonisë.

e) Mandatin e blerjes së dokumenteve, nga Projekti 2KR.

- Për shitjen me këste të mallrave:

a) Dokumente, të noterizuara, të letërnjoftimit ose certifikatë me fotografi të gjendjes civile, ose prokurë të posaçme përfaqësimi.

b) Kërkesën për mallrat që kërkon të blejë.

c) Garancinë bankare kjo të bëhet vetëm në Bankë që vërteton ngurtësimin për llogari të Projektit 2KR të 10 % të vleftës fillestare për mallrat që kërkon të blejë në ankand, dhe jo nga shoqëritë e sigurimeve, detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave.

d) Aktmarrëveshje paraprake e firmosur midis Projektit 2KR dhe pjesëmarrësit në ankand, me qëllim shitjen e mallrave të fituara me ankand në rrethet e përcaktuara sipas studimit dhe në marrëveshje me Qeverinë e Japonisë.

e) Marrëveshjen e garancisë me një nga pikat e servisit të prokuruar nga Projekti 2KR, afati i së cilës është 1 vit nga data e blerjes së mjetit.

f) Formularin e planbiznesit për argumentimin e kthimit të fondit kundërpartit.

g) Mandatin e blerjes së dokumenteve nga Projekti 2KR.

4. Për shitjet me këste të mallrave përfituesi përzgjidhet mbi bazën e të vetmit kriter: Çmimin më të lartë të ofruar.

5. Komisioni i shitjes së mallrave, po ditën e zhvillimit të ankandit del me një vendim në të cilën përcaktohen fituesit e këtij ankandi dhe mallrat e blera prej tyre. Ky vendim firmoset nga i gjithë komisioni dhe miratohet nga drejtori i Projektit 2KR.

6. Brenda 10 ditëve nga dita e shpalljes së fituesve, subjektet fituese janë të detyruara të lidhin kontratën e shitjes me Projektin 2KR duke bërë dhe sigurimin e kontratës me 10 % të vlerës së mallit.

7. Në kontratën e shitjes përcaktohen detyrimet e palëve, afati i shlyerjes së vlerës së plotë, vlera, numri dhe afatet e pagesës së kësteve, si dhe penalitetet për çdo ditë vonesë në shlyerjen e kësteve.

8. Në qoftë se pas kalimit të 10 ditëve nga shpallja e fituesve, përfituesi nuk lidh kontratën e shitjes, ai e humbet të drejtën e blerjes dhe mallrat rishpallen për shitje sipas procedurave të këtij udhëzimi. Në këtë rast vlefta e garancisë prej 10 %, që është ngurtësuar nga përfituesi është e pakthyeshme dhe kjo shumë kalon për llogari të Projektit 2KR. Për pjesëmarrësit jofitues bëhet urdhër për çngurtësimin e vlerës prej 10 %.

9. Tërheqja e mallrave nga pikat e magazinimit bëhet vetëm pasi të jetë lidhur kontrata e shitjes dhe të jetë likuiduar kësti i parë ose vlera e plotë e mallit.

10. Afati maksimal për shlyerjen e kësteve është ai i parashikuar në marrëveshjen e lidhur me Qeverinë e Japonisë. Deri në momentin e shlyerjes përfundimtare të vlerës së mallrave, pronësia mbi këto mallra është e Projektit 2KR. Në momentin e shlyerjes së këstit të fundit nga përfituesi, Projekti

2KR harton kontratën e shitjes me blerësin.

11. Në rastet kur pas zhvillimit të dy ankandeve të njëpasnjëshme, rezulton se nuk ka asnjë kërkesë për blerjen e mallit, komisioni i ankandit propozon një çmim të ri, deri në 30 % më të ulët se vlera e mëparshme, për mallin që nuk ka pasur kërkesa për shitjen e tyre, por jo më të vogël se vlera e llogaritur sipas çmimeve FOB të mallrave të ardhura në kuadër të Projektit 2KR.

12. Projekti 2KR organizon punën me qendrat e servisit, sipas ligjit nr.7971, datë 26.5.1995 “Për prokurimin publik” me ndryshimet përkatëse dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij. Pikat e servisit lidhin marrëveshje garancie me përfituesit për një periudhë njëvjeçare. Përballimi i shpenzimeve të shërbimit teknik bëhet nga fondi kundërparti.

13. Me pikat e përzgjedhura të servisit, Projekti 2KR lidh kontrata shërbimi. Nëpërmjet këtyre kontratave pikat e servisit marrin përsipër shërbimin teknik të mjeteve të mekanikës bujqësore, që do të shiten me këste, për të gjithë periudhën deri në shlyerjen përfundimtare të kësteve nga përdoruesit e këtyre mjeteve. Pikat e servisit bashkëpunojnë me specialistët e Projektit 2KR për grumbullimin e fondit kundërparti.

Për përballimin e shpenzimeve të shërbimit teknik do të përdoret fondi kundërparti i arkëtimit nga përfituesit e traktorëve e të makinerive bujqësore (sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.105, datë 18.2.2005).

Nga Projekti 2KR në fund të vitit do të bëhet bilanci i grumbullimit të fondit kundërparti dhe do të hartohet programi i pagesës së vlerave respektive për çdo pikë servisi.

Pagesa e pikave të servisit bëhet mbi bazën e situacionit të shërbimeve të kryera nga këto pika për mjetet dhe makineritë bujqësore, bazuar në kontratën e lidhur me Projektin 2KR dhe me klientët.

14. Përfituesve që kanë marrë mallra, në shitjet me këste të tyre, dhe që nuk kanë shlyer detyrimet duke filluar nga kësti i dytë, sipas afateve të përcaktuara në kontratën e lidhur me Projektin 2KR, do t’u sekuestrohen mjetet dhe shumat e derdhura deri në atë moment nuk do t’u kthehen. Për këto mjete do të aplikohet rishitja e tyre nëpërmjet procedurave të ankandit.

15. Urdhri për sekuestrimin e mallrave lëshohet nga drejtori i Projektit “Rritja e prodhimit ushqimor, 2KR”.

16. Për marrjen e mallrave në dorëzim pas sekuestrimit të tyre, drejtori i Projektit 2KR ngre një komision të kontrollit teknik, me jo më pak se 3 persona, ku të bëjnë pjesë dhe specialistë të fushës së mekanikës, i cili do të bëjë kontrollin për gjendjen teknike aktuale të mallrave të sekuestruara dhe shkallën e amortizimit të tyre, komisioni do të përpilojë dokumentacionin e nevojshëm për këtë qëllim.

17. Çmimi i mallrave që janë sekuestruar nga përfituesit, që nuk kanë shlyer detyrimet sipas kontratës së lidhur me Projektin 2KR, dhe që do të rishiten, do të përcaktohet nga komisioni i llogaritjes së çmimeve.

Në përcaktimin e çmimeve nga ana e komisionit të llogaritjes së çmimeve duhet të mbahet parasysh çmimi fillestar i shitjes së mallit, shkalla e amortizimit, orët e punës së kryer dhe shpenzimet e riparimit. Për mjetet të cilat do të rishiten, të bëhet rivlerësim i vlerës së tyre dhe komisioni ka të drejtë të propozojë një ulje të çmimit të rillogaritur deri në 50% të vlerës, i cili miratohet nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Mbas rishitjes së këtyre mallrave do të jepet garanci nga ana e pikës së servisit e cila do të mbulojë këto mallra.

Afati maksimal i shlyerjes së kësteve për këto mjete do të jetë jo më shumë se tre vjet nga data e blerjes së tyre.

18. Rishitja e këtyre mallrave bëhet me anë të ankandit, i cili zhvillohet sipas procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim.

19. Për mjetet që do të rishiten, sipas pikës 24 të këtij udhëzimi, përfituesi i ri ka të drejtën e lidhjes së marrëveshjes së garancisë me pikat e servisit.

20. Shitja e mallrave bëhet në lekë. Konvertimi bëhet mbi bazën e kursit mesatar të këmbimit të muajit kur është firmosur marrëveshja me Qeverinë e Japonisë.

KREU V ZHVILLIMI I ANKANDIT

1. Udhëzimi nr.1, datë 22.8.2001 i Ministrisë shfuqizohet.

2. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Projekti "Rritja e prodhimit ushqimor, 2KR".
3. Anekset bashkëngjitur janë pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.
4. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT
DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
Jemin Gjana

ANEKSI NR.1
DOKUMENTET STANDARDE PËR PROCEDURAT E ANKANDIT
TË PROJEKTIT 2KR

Përmbajtja:

1. Ftesa për ankand.
2. Përshkrimi i objektit konkret të shitjes me ankand.
3. Formulari i ftesës për ankand për konkurruesit fizikë/juridikë.
4. Formulari i sigurimit të ofertës i lëshuar nga bankat.
5. Formulari i sigurimit të kontratës i lëshuar nga bankat.

Komisioni i ankandit

Datë ____/____/200__.

FTESË PËR ANKAND

Projekti "Rritja e prodhimit ushqimor, 2KR" fton individët, personat fizikë e juridikë, për të marrë pjesë në ankandin për shitjen e _____ (lloji, sasia e mallit dhe të dhëna të përgjithshme mbi mallin në shitje).

Të interesuarit mund të tërheqin dokumentacionin e ankandit pranë zyrës juridike të Projektit 2KR, pranë Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, me adresë: "Sheshi

“Skënderbej”, nr.2 Tiranë, Tel:_____, Fax:_____, kundrejt një pagese prej _____ lekësh.

Hapja e dokumentacionit do të bëhet në datë _____, ora _____ në adresën e mësipërme.

Për Projektin 2KR

Kryetari i komisionit të ankandit

FORMULARI I OFERTËS PËR ANKAND
(PËR KONKURRUESIT, PERSON FIZIK OSE JURIDIK)

_____, më datë _____

_____ me seli në _____
(emërtimi i personit fizik ose juridik) (adresa e plotë)

Pasi u njoh me dokumentet e ankandit që organizon Projekti 2KR për shitjen e _____
(lloji i mallit), paraqet ofertën si më poshtë vijon:

Për objektin _____
Çmimi që ofrohet _____

(vlera në lekë me shifra dhe fjalë)

Vlefshmëria e kësaj oferte është _____ ditë.
(numër e fjalë)

KONKURRUESI

(Emri i personit fizik ose juridik.
Emër, mbiemër i titullarit, nënshkrimi, vula)

**FORMULARI PËR SIGURIMIN E OFERTËS PËR PJESËMARRJE NË ANKAND
GARANCI BANKARE**

Nr. ref. _____

Datë _____

Me të cilën vërtetojmë se _____ (emri i subjektit), ka ngurtësuar në llogarinë e tij, pranë Bankës _____, shumën prej _____ lekë si kusht për sigurimin e ofertës së paraqitur pranë Projektit "Rritja e prodhimit ushqimor, 2KR" për pjesëmarrje në ankandin e shitjes _____ që do të zhvillohet në datën _____.

Banka _____ merr përsipër të kalojë shumën e ngurtësuar prej _____ lekë për llogari të Projektit "Rritja e prodhimit ushqimor, 2KR";

në rast se:

1. Pjesëmarrësi në ankand, i shpallur fitues, nuk lidh kontratë brenda afateve të caktuara,
2. Nuk paraqet garancinë bankare për sigurimin e kontratës.

Me paraqitjen e kërkesës së parë me shkrim pranë Projektit "Rritja e prodhimit ushqimor, 2KR" pa kërkuar shpjegime, me kusht që në kërkesë të përmendet mosplotësimi i një prej kushteve të mësipërme.

Banka _____ çliron garancinë bankare vetëm pas njoftimit me shkrim të Projektit "Rritja e prodhimit ushqimor, 2KR", për llogari të së cilës është ngurtësuar shuma e mësipërme.

Kjo garanci bankare është e vlefshme deri më 30 ditë pas datës së zhvillimit të ankandit.

(Emri i bankës)

(Nënshkrimi dhe vula)

**FORMULARI PËR SIGURIMIN E KONTRATËS
GARANCI BANKARE**

Nr. ref. _____

Datë _____

Duke qenë se: _____ është shpallur fitues i ankandit të zhvilluar
(subjekti, emër mbiemër)

nga Projekti "Rritja e prodhimit ushqimor, 2KR", në bazë të kontratës me nr. _____, datë
_____, ka fituar të drejtën e blerjes me këste të objektit _____, me
vlerë totale _____ lekë

(me shifra dhe me fjalë)

jepet garanci në shumën prej _____ lekë, ne
deklarojmë se jemi garantuesit e kontratës së mësipërme si sigurim për përmbushjen e detyrimeve të
parashikuara në kontratë, deri në shumën totale prej _____ lekë, shumë e cila është
e pagueshme në mënyrën dhe monedhën e përcaktuar në kontratë.

Ne marrim përsipër të paguajmë, sapo të bëni kërkesën e parë me shkrim dhe pa qenë nevoja
të bëni argumentim të kërkesës, çdo shumë brenda kufirit prej _____ lekë, në
llogarinë e Projektit "Rritja e prodhimit ushqimor, 2KR" me numër llogarie në bankën
_____.

Me këtë garanci ju sigurojmë se nuk është nevoja t'i drejtoheni më parë kontraktuesit
_____ për të realizuar pagesën sipas kërkesës suaj.

Deklarojmë gjithashtu, se asnjë shtesë apo ndryshim i kushteve të kontratës, për të cilën ju
mund të bini dakord me kontraktuesin, nuk na çliron nga detyrimet e kësaj garancie bankare.

Kjo garanci bankare është e vlefshme deri më 30 ditë pas datës së përfundimit të kontratës.

(Emri i bankës)

(Nënshkrimi dhe vula)

ANEKS NR.3



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE
MBROJTJES SË KONSUMATORIT
PROJEKTI 2KR**

Adresa: sheshi "Skënderbej", nr.2, Tiranë

Tel: + 4 22 83 18 ; Fax: + 4 24 82 08

Nr _____ Prot.

Tiranë, më _____ 2006

V Ë R T E T I M

I kalimit të pronësisë së _____

Z. _____ i shpallur fitues në ankandin e shitjes me këste të _____ bujqësore të ardhura në kuadër të Projektit "Rritja e prodhimit ushqimor, 2KR", ka shlyer në bazë të vërtetimit nr. _____ prot, datë _____ 2006 një shumë prej _____ lekë, të barabartë me fondin total të kontratës së shitjes me kusht nr. _____, datë _____.

Bazuar në udhëzimin nr. _____, datë _____ "Për zbatimin e pikës 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.148, datë 31.3.2000 "Për mënyrën e shitjes së mallrave të ardhura grant nga Japonia në kuadër të Projektit "Rritja e prodhimit ushqimor, 2KR",

Z. _____ i kalon pronësia mbi mallrat si më poshtë:

1. Mjet bujqësor _____, Tipi _____, Prodhim _____, viti i prodhimit _____, me numër shasie _____, fuqi _____.
2. Mjet bujqësor _____, Tipi _____, Prodhim _____, viti i prodhimit _____, me numër shasie _____, fuqi _____.
3. Mjet bujqësor _____, Tipi _____, Prodhim _____.

_____, viti i prodhimit _____, me numër shasje _____, fuqi_____.

DREJTORI

ANEKS NR.2



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE
MBROJTJES SË KONSUMATORIT
PROJEKTI 2KR**

Adresa: sheshi “Skënderbej”, nr.2, Tiranë Tel: + 4 22 83 18; Fax: + 4 24 82 08

Tiranë më _____

**KONTRATË SHITJEJE ME REZERVË
PASURI E LUAJTSHME**

Sot, më dt. _____ në ambientet e Projektit 2KR, pranë Ministrisë së Bujqësisë Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit në adresën: sheshi “Skënderbej” nr.2 Tiranë,

me cilësinë e shitësit: Projekti “Rritja e prodhimit ushqimor 2KR”, me adresë pranë Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, sheshi “Skënderbej”, nr.2, Tiranë, i përfaqësuar nga Drejtori z. _____ me dokument identifikimi nr. _____,

dhe me cilësinë e blerësit fituesi i ankandit të datës _____:
z. _____ i biri i _____ i datëlindjes _____ banues
në _____, përfaqësues i subjektit _____ me autorizim në emër të shoqërisë
_____ madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar me dokument identifikimi
_____ me nr. _____

Të dyja palët, me vullnetin e tyre të lirë, nënshkruajnë këtë kontratë shitjeje me rezervë, si më poshtë vijon:

**Neni 1
Baza ligjore**

Kontrata e shitjes me rezervë lidhet në mbështetje të nenit 705 deri 749 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, të cilat bëjnë fjalë për shitjen me rezervë të pronës. Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.600, datë 2.11.2001 “Për mënyrën e shitjes së mallrave të ardhura grant nga Japonia në

kuadër të Projektit “Rritja e prodhimit ushqimor, 2KR”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.555, datë 16.8.2006 “Për kthimin e fondeve financiare nga subjektet që përfitojnë nga përdorimi i fondit kundërparti të granteve japoneze për Projektin “Rritja e prodhimit ushqimor, 2KR”, dhe për një ndryshim në vendimet nr.479, datë 19.7.2001, nr.373, datë 6.6.2003 dhe nr.114, datë 25.2.2005”, si dhe me udhëzimin nr. _____ datë _____ të Ministrisë së Bujqësisë dhe urdhrin nr. _____, datë _____, vendimit nr. _____, datë _____ të komisionit të ankandit.

Neni 2

Objekti i kontratës

Objekti i kësaj kontrate shitjeje me rezervë është shitja e objektit _____, bazuar në dokumentacionin _____, datë _____ të lidhur me subjektin _____ dhe deklaratës së zhdoganimit, planbiznesit të subjektit të paraqitura pranë subjektit 2KR, me specifikimet e mëposhtme:

1. Marka: _____
2. Tipi: _____
3. Fuqia: _____
4. Viti i prodhimit: _____
5. Vlera e shitjes me ankand: _____
6. Vlera e kontratës në lekë është: _____
7. Monedha në të cilën do të paguhet është: _____
8. Sistemi ftohës: _____

Neni 3

Mënyra e pagesës

Projekti 2KR i shet blerësit _____

Mënyra e pagesës do të jetë me këste të shlyeshme në afatet e mëposhtme:

KËSTET	Vlera	Data e pagesës
Kësti i parë		
Kësti i dytë		
Kësti i tretë		
Kësti i katërt		
Kësti i pestë		
Kësti i gjashtë		
Kësti i shtatë		
Kësti i tetë		
Kësti i nëntë		
Kësti i dhjetë		
Kësti i njëmbëdhjetë		
Kësti i dymbëdhjetë		
Kësti i trembëdhjetë		
Kësti i katërmëdhjetë		

Pagesa e kësteve duhet të bëhet në llogarinë me nr. _____ të fondit kundërparti të Projektit 2KR në bankën _____.

Afati i shlyerjes së vlerës së kontratës është _____ vjet.

Për çdo ditë vonesë në pagimin e kështit do të aplikohet një kamatëvonesë ditore 1% e vlerës së kështit të papaguar, e llogaritur kjo për çdo ditë pune të administratës shtetërore.

Neni 4
Pronësia

Projekti “Rritja e prodhimit ushqimor, 2KR” ruan pronësinë mbi objektin _____ deri në momentin kur blerësi kryen shlyerjen e plotë të vlerës së objektit _____.

Neni 5
Detyrimet e shitësit

- T’i dorëzojë blerësit objektin _____, i cili në çastin e marrjes në dorëzim është në gjendje të rregullt teknike.

- Të pajisë blerësin me dokumentacionin e nevojshëm.

- Projekti 2KR nuk mban përgjegjësi për problemet teknike që mund të lindin gjatë periudhës së punës së objektit _____

- Pronësia mbetet e Projektit 2KR deri në shlyerjen e të gjitha kësteve dhe likuidimit të plotë të vlerës së shitjes me ankand.

- Me përfundimin e pagesës së kështit të fundit, Projekti “Rritja e prodhimit ushqimor, 2 KR” i kalon pronësinë blerësit duke e pajisur atë me vërtetim pronësie.

Neni 6
Detyrimet e blerësit

- Blerësi është i detyruar të lërë si garanci të gjitha parapagimet e bëra më parë deri në shlyerjen e plotë të kështit të fundit.

- Blerësi është i detyruar të mos ndryshojë destinacionin e objektit.

- Gjatë kohës që blerësi nuk është bërë akoma pronar i objektit, ai nuk mund ta shesë dhe nuk mund ta japë me qira objektin _____.

- Blerësi është i detyruar të kryejë pagesat e rregullta të të gjitha kësteve sipas kontratës deri në shlyerjen e plotë të saj.

- Të mbajë kontakte të vazhdueshme me Projektin 2KR dhe të njoftojë në çdo kohë për ndryshim adrese apo të telefonit të kontaktit.

- Blerësi është i detyruar t’u krijojë kushte ekipeve të kontrollit të Projektit 2KR dhe të japë të gjithë informacionin që i kërkohet nga Projekti 2KR në lidhje me ecurinë dhe volumin e punimeve të kryera prej tij, veprimtarinë financiare etj. deri në momentin e pagimit të kështit të fundit.

- Për efekt të koston së prodhimit dhe llogaritjes së rezultatit financiar, subjekti privat llogarit amortizimin e objektit të blerë me këste dhe kontabilizon sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 7
Sanksionet

- Në rast se përftuesi pagues i rregullt i kësteve nuk paguan 2(dy) nga këstet e radhës, të cilat janë të pasqyruara në kontratë për mallrat, pajisjet sekuestrohen menjëherë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi pa asnjë rimbursim të kësteve të mëparshme.

Neni 8
Dispozita e fundit

- Kjo kontratë shitjeje me rezervë hartohet në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

- Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga zbatimi i kësaj kontrate, palët i drejtohen Gjykatës së Rethit Gjyqësor Tiranë.

- Kjo kontratë përpilohet në 3 kopje origjinale, prej të cilave një e mban blerësi, një Projekti 2KR dhe një në arkivën e Projektit 2KR.

Shitësi

Blerësi

Për Projektin 2KR

Për subjektin

Drejtori

UDHËZIM
Nr.6, datë 8.11.2006

**PËR DOKUMENTACIONIN TEKNIKO-LIGJOR PËR MIRATIMIN E KUFIRIT TË
ZONËS/VENDBANIMIT/BLLOKBANIMIT/NDËRTIMIT INFORMAL TË VEÇUAR DHE
TË TERRITOREVE TË TJERA ME NDËRTIME PA LEJE**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 1.1 të nenit 11 dhe nenit 45 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”,

UDHËZOJ:

1. Njësia e qeverisjes vendore, për të realizuar grupimin e ndërtimeve pa leje, emërtimin e territorit të zënë dhe për të përcaktuar kufirin e zonës/vendbanimit/bllokbانيت/ndërtimit informal të veçuar dhe të territoreve të tjera, për efekt vendimmarrjeje, i referohet:

- a) gjendjes faktike të situatës ndërtimore;
- b) identifikimit dhe verifikimit të ndërtimeve pa leje në terren dhe në hartë;
- c) vendndodhjes së objekteve;
- d) madhësisë së territorit me ndërtime pa leje;
- e) kufirit territorialo-administrativ të njësive të qeverisjes vendore dhe vijave kufizuese të ndërtimit (vija e verdhë);
- f) studimeve urbanistike dhe të infrastrukturës në nivel kombëtar e rajonal të miratuara ose në proces;
- g) studimeve urbanistike të tjera, të miratuara deri në datën e hyrjes në fuqi të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”;
- h) statusit të sipërfaqes së tokës së zënë;
- i) morfologjisë dhe kushteve të relievit;
- j) mbrojtjes së veçantë ligjore që gëzojnë zona të caktuara.

1.1 Për Bashkinë e Tiranës, realizimi i grupimit të ndërtimeve pa leje, emërtimi i territorit të zënë dhe përcaktimi i kufirit të zonës/vendbanimit/bllokbانيت/ndërtimit informal të veçuar dhe të territoreve të tjera, bëhet nga njësiti bashkiake.

2. Për propozimin dhe miratimin e kufirit të zonës/vendbanimit informal me ndërtime pa leje, zyra e urbanistikës së njësisë së qeverisjes vendore përgatit dokumentacionin tekniko-ligjor, i cili përmban:

a) hartën e zonës/vendbanimit informal të përditësuar, në shkallën 1:1000 deri 1:2500 me kufirin e propozuar dhe sipërfaqen (e shprehur në shifra në relacion dhe në legjendën e hartës).

Në këtë hartë mbivendosen:

i) studimet urbanistike dhe të infrastrukturës në nivel kombëtar e rajonal, të miratuara ose në proces;

ii) infrastrukturën inxhinerike;

iii) zonat që gëzojnë mbrojtje të veçantë ligjore;

iv) kufirin administrativo-territorial të njësisë/-ve së/të qeverisjes vendore dhe vijën e ndërtimit (vija e verdhë).

b) hartën e shkallës 1:2500 deri në 1:25000, ku paraqitet zona e propozuar në raport me kufijtë

administrativë;

c) hartën kadastrale në shkallën 1:1000 deri 1:2500, ku pasqyrohet situata e pronësisë mbi tokën;

d) hartën e shkallës 1:1000 deri 1:2500, ku paraqitet boniteti i tokës;

e) numrin total të ndërtimeve pa leje të deklaruara dhe të padeklaruara;

f) pasqyrën përmbledhëse të të dhënave për ndërtimet pa leje;

g) relacionin me argumentimin tekniko-ligjor për propozimin e kufirit të zonës/vendbanimit informal.

3. Për realizimin e dokumentacionit të paraqitur në pikën 2 të këtij udhëzimi, njësia e qeverisjes vendore bashkëpunon me Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme ose/dhe strukturat rajonale përkatëse.

4. Propozimi për miratimin e kufirit, për zonën informale dhe vendbanimin informal, shqyrtohet dhe miratohet në këshillin e qarkut.

5. Vendimi i këshillit të qarkut, së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor depozitohen pranë zyrës qendrore të ALUIZNI-t.

6. Zyra qendrore e ALUIZNI-t përgatit oponencën dhe e paraqet në sekretarinë e KRRTRSH-së për emërtim dhe miratim të kufirit të zonës/vendbanimit informal, së bashku me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesën e këshillit të qarkut drejtuar KRRTRSH-së;

b) vendimin e këshillit të qarkut;

c) dokumentacionin e përcaktuar në pikën 2 të këtij udhëzimi;

d) mendimin e marrë nga institucionet e përcaktuara në pikën 3 të këtij udhëzimi.

7. Vendimi i miratimit të kufirit dhe emërimit të zonës/vendbanimit informal, nga KRRTRSH-ja, i përcillet njësive të qeverisjes vendore për përcaktimin e kufijve dhe sipërfaqeve të parcelave ndërtimore.

8. Njësia e qeverisjes vendore, për përcaktimin e kufijve dhe sipërfaqeve të parcelave ndërtimore për zonën/vendbanimin informal, përgatit:

a) hartën e shkallës 1:1000 deri 1:2500, sipas madhësisë së zonës, ku paraqitet kufiri i miratuar nga KRRTRSH-ja dhe parcelat përkatëse të objekteve;

b) hartën kadastrale të zonës, në shkallën 1:1000 deri 1:2500, ku të pasqyrohet situata e pronësisë mbi tokën.

9. Kufijtë e secilës parcelë përcaktohen në përputhje me:

a) kufirin e zonës së miratuar nga KRRTRSH-ja;

b) studimet urbanistike;

c) ndarjen territorial-administrative;

d) zonat e mbrojtura nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

10. Për përcaktimin e kufijve të secilës parcelë duhet të merret në konsideratë infrastruktura dhe rrjeti inxhinerik.

11. Shqyrtimi dhe miratimi i kufirit për bllokbanimet/ndërtimet informale dhe territoret e tjera, kufiri dhe sipërfaqja e parcelës për secilin objekt realizohet nga KRRT-të e njësive të qeverisjes vendore me një vendimmarrje të vetme.

12. Për propozimin dhe miratimin në KRRT të kufirit të bllokbanimeve/ndërtimeve informale dhe territoreve të tjera, të kufirit dhe sipërfaqes së parcelave të objekteve, zyra e urbanistikës së njësive të qeverisjes vendore përgatit dokumentacionin tekniko-ligjor, sipas pikës 2 dhe 3 të këtij udhëzimi.

13. Për objektet e veçanta pa leje dhe për shtesat pa leje në ndërtimet me leje, vendimmarrja realizohet në KRRT-të e njësive të qeverisjes vendore. Dokumentacioni i domosdoshëm që do të paraqitet do të jetë sipas pikës 2-a/b/c/d/g të këtij udhëzimi.

14. Në rastet kur njësia e qeverisjes vendore nuk ushtron përgjegjësitë, për shkaqet e parashikuara në pikën “d” neni 4 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, kompetencat e njësive të qeverisjes vendore, me vendim të Këshillit të Ministrave, i kalojnë ALUIZNI-t.

15. Vendimet e KRRT-së/KRRTRSH-së do të jenë baza për përgatitjen e genplanit në shkallën

1:500 për parcelën dhe objektin që legalizohet dhe do të realizohet në përputhje të plotë me to.
16. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT
DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Lulzim Basha

UDHËZIM
Nr.7, datë 8.11.2006

PËR MËNYRËN E PLOTËSIMIT DHE RUAJTJEN E TË DHËNAVE
PËR NDËRTIMET PA LEJE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 2 të nenit 12 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”,

UDHËZOJ:

1. Përzgjedhja dhe mbledhja e të dhënave për ndërtimet pa leje
 - a) Njësia e qeverisjes vendore, për të realizuar përzgjedhjen dhe mbledhjen e të dhënave të nevojshme për procesin e legalizimit të ndërtimeve pa leje, shfrytëzon:
 - i) të dhënat e përfutuara nga/gjatë etapës së vetëdeklarimit;
 - ii) të dhënat e përfutuara nga/gjatë etapës së identifikimit në terren;
 - iii) të dhënat e përfutuara nga/gjatë etapës së plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor.
 - b) Këto të dhëna kanë të bëjnë me vetëdeklaruesin e ndërtimit pa leje, ndërtimin/objektin pa leje dhe me parcelën ndërtimore.
 - c) ALUIZNI përpunon të dhënat e mbledhura nga njësiti e qeverisjes vendore, të cilat do të shërbejnë për monitorimin, realizimin e procesit të legalizimit, regjistrimin fillestar të ndërtimeve pa leje, kompensimin dhe për urbanizimin e integrimin e territoreve informale.
 - d) Me të dhënat e mbledhura nga njësiti e qeverisjes vendore gjatë etapave të ndryshme, ALUIZNI do të krijojë bazën e të dhënave (*data base*) të procesit të legalizimit.
2. Të dhënat e përfutuara nga/gjatë etapës së vetëdeklarimit

Nga regjistri i të dhënave të formularëve “Vetëdeklarim për legalizim objekti” (A dhe A1), i cili përbën një bazë të rëndësishme të dhënash për vazhdimësinë e procesit, njësia e qeverisjes vendore selekton dhe shfrytëzon këto elemente:

 - a) numrin e dosjes së vetëdeklarimit të ndërtimit pa leje, i cili është numër unik brenda bashkisë/komunës dhe do të shërbejë si element identifikues për objektin deri në përfundim të procesit;
 - b) emrin, atësinë dhe mbiemrin e plotë të vetëdeklaruesit;
 - c) datën e vetëdeklarimit, e cila do të shërbejë për përcaktimin e sanksioneve financiare të zbatueshme për etapën e vetëdeklarimit.
3. Të dhënat e përfutuara nga/gjatë etapës së identifikimit në terren
 - a) Grupet e punës të ngritura nga njësia e qeverisjes vendore, përmes hartimit të procesverbalit të konstatimit, saktësojnë dhe grumbullojnë në terren të dhëna reale për gjendjen ndërtimore të objekteve dhe gjendjen e parcelave ndërtimore.

Këto të dhëna janë:

 - i) sipërfaqja e parcelës ndërtimore;
 - ii) sipërfaqja totale e ndërtimit;
 - iii) sipërfaqja e bazës së objektit;
 - iv) numri i kateve të objektit pa leje;
 - v) funksioni i hapësirave të objektit pa leje;
 - vi) qëllimi i shfrytëzimit të objektit pa leje (qiradhënie/shitblerje);
 - vii) kualifikimi paraprak për ndërtimet pa leje (vazhdojnë procedurat e legalizimit/nuk legalizohen/pezullohen);
 - viii) data e identifikimit në terren.
- b) Të dhënat e grumbulluara do të paraqiten në formë tabelore (tabela nr.1 bashkëngjitur këtij

udhëzimi) dhe plotësimi i saj do të realizohet sipas grupimevezone /vendbanim/ bllokbanim /ndërtim informal dhe terriore të tjera, si dhe për shtesat pa leje në objekte me leje.

c) Përpunimi i të dhënave të përfituara nga tabela nr.1 dhe nga hartat dixhitale, produkt i fotografisë ajrore, do të shërbejnë për hartimin dhe përputhjen e plotë të parcelave ndërtimore (genplaneve).

4. Të dhënat e përfituara pas vendimmarrjes në KRRT / KRRTRSH

Këto të dhëna kanë të bëjnë me:

a) emërtimin e territorit informal;

b) kualifikimin e objekteve për legalizim (po, jo, pezullohen);

c) ridimensionimin e sipërfaqeve të parcelave ndërtimore dhe/ose sipërfaqes së ndërtimit.

5. Të dhënat e përfituara përmes procedurave për plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor

a) Gjatë plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor, njësia e qeverisjes vendore grumbullon të dhënat e mëposhtme:

i) numrin e zonës kadastrale;

ii) numrin e pasurisë;

iii) adresën e plotë të pasurisë (qarku, qyteti/fshati, rruga/lagjja, pallati/godina, shkalla/kati, apartamenti);

iv) sipërfaqen e parcelës ndërtimore;

v) sipërfaqen totale të ndërtimit;

vi) sipërfaqen e bazës së objektit;

vii) dokumentin me të cilin gëzon/fiton pronësinë mbi tokën (ligj, vendim, kontratë, trasaksion etj.);

viii) pjesëmarrjen në bashkëpronësi;

ix) vlerën e paguar për parcelën ndërtimore.

b) Të dhënat e grumbulluara do të pasqyrohen në tabelën nr.2 bashkëngjitur këtij udhëzimi, me përjashtim të rubrikës “Kufizimet D/E”. Këto të dhëna, së bashku me ato të përfituara nga leja e legalizimit, do të shërbejnë për regjistrimin fillestar të pasurisë.

6. Administrimi dhe ruajtja e të dhënave të grumbulluara

a) Të gjitha të dhënat e përmendura në këtë manual do të plotësohen, administrohen dhe ruhen nga njësitë e qeverisjes vendore, në formë dixhitale (*cd*) dhe shkresore (*hard copy*).

b) Të dhënat duhet të jenë të sakta, të plota dhe nuk mund të përdoren për qëllime që nuk janë parashikuar në këtë udhëzim.

c) Informacioni për ecurinë do t’u përcillet në mënyrë periodike drejtorive rajonale të ALUIZNI-t.

d) Njësitë e qeverisjes vendore, të dhënat përfundimtare sipas zonimeve do t’ia përcjellin drejtorive rajonale të ALUIZNI-t, në dy kopje, në formë dixhitale (*cd*) dhe shkresore (*hard copy*). Materialet shkresore duhet të mbajnë firmën e kryetarit dhe vulën e njësisë së qeverisjes vendore.

e) Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t krijon sistemin e saj të përpunimit dhe administrimit të të dhënave, që do të shërbejë për legalizimin e objekteve pa leje dhe për regjistrimin fillestar, si dhe për ecurinë e të gjitha etapave të procesit.

f) Hartat dixhitale, produkt i fotografimit ajror, së bashku me infomacionet e mbledhura gjatë etapave të ndryshme, janë të dhënat bazë që do të shërbejnë për realizimin e procesit të legalizimit, regjistrimit fillestar, urbanizimit dhe integritetit të terrioreve me ndërtime pa leje.


7. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT
DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Lulzim Basha

TABELA Nr.1

Qarku _____ Bashkia/Komuna _____ Fshati/Rajoni _____
Zona _____

Nr.	Nr. i dosjes	Emër	Adresi	Mbiemër	Data e vetdeklarimit	Sipërfaqjet			Nr. kateve	Funksioni/Qëllimi			Data e identifikimit në terren	Kualifikimi paraprak
						parcela	ndërtimi	baza		banesë	funkcion social-ekonomik	e kombinuar		
1														
2														
3														
4														
5														
6														
7														
8														
9														
10														
11														
12														
13														
14														
15														
16														
17														
18														
19														
20														
21														
22														
23														
24														
25														
26														
27														



URDHËR

Nr.8, datë 30.10.2006

**PËR MIRATIMIN E MANUALIT TË HARTIMIT DHE PARAQITJES
SË MATERIALEVE GRAFIKE**

Në mbështetje të shkronjës “c” pika 2 të nenit 4 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e manualit “Për hartimin dhe paraqitjen e materialeve grafike”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Drejtoritë rajonale të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, njësitë e qeverisjes vendore, gjatë hartimit dhe paraqitjes së materialeve grafike, të veprojnë sipas përcaktimeve të bëra në këtë manual.

3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Shaban Memia**

**MANUAL
PËR HARTIMIN DHE PARAQITJEN E MATERIALEVE GRAFIKE**

Ky manual shërben për unifikimin dhe standardizimin e procedurave në hartimin dhe paraqitjen e materialeve grafike nga specialistët e urbanistikës dhe të ALUIZNI-t.

Materiali grafik dhe të dhënat e përftuara sipas kritereve të përcaktuara në këtë manual do të shërbejnë për plotësimin e bazës së të dhënave në përputhje me nomenklaturën e sistemit të legalizimit dhe të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

1. Procedurat për hartimin e materialeve grafike

1.1 Në bazë të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.437, datë 28.6.2006 “Për procedurat e mbledhjes, përpunimit dhe administrimit të të dhënave për ndërtimet pa leje për ngritjen e bazës së të dhënave”, njësia e qeverisjes vendore, gjatë identifikimit në terren të ndërtimeve pa leje, bazuar në hartën kadastrale, kryen matjet e domosdoshme për hartimin e procesverbalit të konstatimit, miratuar me urdhrin nr.46, datë 18.7.2006 të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t, dhe matje të tjera shtesë për përgatitjen e genplanit. Të dhënat e terrenit shënohen në skicën fushore. Në skicë duhet të jenë të dallueshme përmasat e të gjitha elementeve: gjatësitë e kontureve të parcelës ndërtimore, të kontureve të objektit, largësitë nga pikat ekstreme të pronës dhe objekteve, hyrja për në parcelë, si dhe hyrja për në objekt.

1.2 Matjet kryhen në mënyrë që saktësia e tyre të plotësojë kushtet teknike të përcaktuara në standardet e manualeve teknike gjeodezike. Skica duhet të vizatohet në mënyrë që të jetë e lexueshme, pa deformime, shmangie apo korrigjime të vijave. Skica do të shoqërohet me librezën e matjeve fushore dhe çdo material tjetër të përdorur për kompletimin e matjeve.

1.3 Në skicë shënohet emri, atësia, mbiemri dhe adresa e poseduesit, si dhe emri, mbiemri dhe nënshkrimi i hartuesit dhe data e përpilimit të saj.

1.4 Matjet për hartimin e procesverbalit të konstatimit, kryhen në vijueshmëri territoriale, sipas grupimit për zonën/bllokbanimin/vendbanimin informal.

Në përfundim të tyre, grupi i ekspertëve pranë njësisë së qeverisjes vendore përditëson e harton materialet grafike si më poshtë:

- a) hartën e territorit të përditësuar;
- b) genplanin në shkallën 1:500;
- c) planimetritë në shkallën 1:100.

2. Modeli i paraqitjes së genplanit të parcelës ndërtimore.

2.1 Pas miratimit të kufirit të zonës/bllokbanimit/vendbanimit informal, ndërtimit informal të

veçuar apo territoreve të tjera nga KRRT/KRRTRSH, njësia e qeverisjes vendore, brenda 10 ditëve, miraton planveprimin për hartimin e genplaneve të parcelave ndërtimore, në vijueshmëri territoriale, për njërën nga kategoritë e mësipërme.

Në planveprim përcaktohen grupet e punës, kalendari i veprimtarisë për secilin grup etj.

2.2 Genplani hartohet:

a) bazuar në skicën fushore, sipas pikës 1 të këtij manuali;

b) bazuar në verifikimet e bëra në terren (nëse lind nevoja), të shoqëruara me matjet përkatëse, në mënyrë që:

i) të mos ketë shmangie lineare më të madhe se $0.2 \text{ m/m} \cdot \text{SH}$ (që në shkallën 1:500 është 10 cm);

ii) të plotësohet me të dhënat e kërkuara në pikën 1.3 të këtij manuali;

c) bazuar në kufirin e zonës/vendbanimit/bllokbanimit informal, ndërtimit informal të veçuar, territoreve të tjera, miratuar me vendim të KRRT-së.

2.3 Genplani i objektit dhe parcelës ndërtimore përkatëse hartohet në shkallën 1:500, në format A4/A3, sipas modelit G-1, bashkëngjitur këtij manuali.

2.4 Në genplan paraqitet emërtimi që merr zona/bllokbanimi/vendbanimi informal, ndërtim informal i veçuar, pas vendimmarrjes në KRRT/KRRTRSH, si dhe numri i dosjes së vetëdeklarimit të objektit.

2.5 Genplani (modeli G-1 bashkëngjitur manualit) përbëhet nga gjashtë rubrika:

a) Në rubrikën e parë përcaktohen:

i) njësia e qeverisjes vendore, brenda kufirit administrativ të së cilës ndodhet objekti;

ii) emri, mbiemri dhe nënshkrimi i hartuesit të genplanit;

iii) data e përpilimit të genplanit;

iv) emri, mbiemri, nënshkrimi i drejtorit/përgjegjësit të njësies së urbanistikës dhe vula përkatëse.

b) Rubrika e dytë përmban të dhënat e identifikimit të pasurisë:

i) zonën kadastrale;

ii) numrin e pasurisë marrë nga harta ekzistuese kadastrale, në të cilën identifikohet parcela ndërtimore;

iii) indeksin e hartës dhe shkallën përkatëse, në të cilën përfshihet parcela ndërtimore (si indeks i hartës do të përdoret nomenklatura e hartës ekzistuese kadastrale);

iv) shkallën e përdorur në hartimin e genplanit, e cila është 1:500;

v) adresën e pasurisë (qarku, qyteti, fshati, lagjja, rruga, pallati/godina, shkalla, kati, apartamenti);

vi) sipërfaqen e parcelës ndërtimore në m^2 ;

vii) sipërfaqen e ndërtimit, duke iu referuar sipërfaqes së bazës së objektit;

viii) emrin, atësinë dhe mbiemrin e poseduesit të objektit.

2.6 Në rastin kur parcela ndërtimore që posedohet nga deklaruesi e kalon sipërfaqen e parashikuar në ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, dhe poseduesi përfiton vetëm një pjesë të saj (sipërfaqen e përcaktuar në ligj), kësaj të fundit i vendoset numri i ri i pasurisë, i cili është fraksion i numrit origjinë.

2.7 Nëse parcela ndërtimore ndodhet në më tepër se një pasuri, si numër origjinë konsiderohet ai i pasurisë në të cilën ka zënë sipërfaqen më të madhe.

c) Në rubrikën e tretë paraqitet planvendosja e objektit dhe e parcelës ndërtimore, si pjesë e hartës së përditësuar të territorit. Elementet përbërëse të saj janë:

i) shenja orientuese e veriut (në anën e majtë lart);

ii) paraqitja planimetricë e parcelës ndërtimore dhe e objektit të ngritur në të, së bashku me ngrehinat funksionale (në qendër);

iii) hyrja në parcelë dhe hyrja në objekt;

iv) numri i pasurisë së objektit/parcelës dhe objekteve/parcelave të tjera kufitare;

v) emërtimet e rrugëve që ndodhen pranë parcelës ndërtimore;

vi) numri i kateve të objektit, si dhe i objekteve kufitare.

2.8 Për shtesat pa leje mbi objektet e ndërtuara para vitit 1993, në genplan do të paraqitet sipërfaqja e bazës së objektit ekzistues (të ndërtuar para vitit 1993) dhe sipërfaqja e bazës së objektit shtesë të ndërtuar në të. Këto dy sipërfaqe të jenë të dallueshme nga njëra-tjetra.

2.9 Për shtesat pa leje mbi objektet me leje nga KRRT/KRRTSH, rubrika e planvendosjes së objektit, si pjesë e hartës së përditësuar, bazohet te planvendosja e lejes së sheshit dhe e lejes së ndërtimit, lëshuar nga KRRT/KRRTSH-ja. Rubrikat e tjera plotësohen sipas përcaktimeve të bëra në këtë manual.

d) Në rubrikën e katërt paraqiten kufitarët e objektit me emrat përkatës (nëse ka) dhe numrat e pasurisë.

e) Rubrika e pestë paraqet legjendën e genplanit me shenjat konvencionale sipas modelit të dhënë.

f) Rubrika e gjashtë përmban:

i) emrin, mbiemrin, nënshkrimin e personit përgjegjës të sektorit të hartografisë në drejtorinë rajonale të ALUIZNI-t;

ii) emrin, mbiemrin, nënshkrimin e drejtorit të drejtorisë rajonale të ALUIZNI-t dhe vulën përkatëse.

3. Procedurat e ndërmarra nga drejtoria rajonale e ALUIZNI-t

Genplanet e përgatitura nga njësitë e qeverisjes vendore, të hartuara në 4 (katër) kopje, kontrollohen nga specialistët përkatës në drejtorinë rajonale të ALUIZNI-t, në formën e tyre dixhitale dhe përmes verifikimit në terren, në përputhje me hartën e përditësuar.

Kontrolli në formë dixhitale mundëson verifikimin e çdo genplani të paraqitur.

Për të realizuar kontrollin në terren të genplaneve do të aplikohet metoda e sondazhit, me një normë kontrolli 10% të numrit të përgjithshëm të genplaneve, brenda kufirit të territorit të miratuar. Pas kontrollit hartohet procesverbali i rezultatit.

Në rastin kur nga kontrolli rezulton se genplanet janë të sakta, bëhet konfirmimi i të gjithë genplaneve të territorit. Kur nga kontrolli rezultojnë mbivendosje, deformime dhe çdo pasaktësi tjetër, genplanet i kthehen njësisë së qeverisjes vendore për t'u ribërë.

4. Modeli i paraqitjes të planimetrisë së objektit

a) Planimetria e çdo kati hartohet në shkallën 1:100, në format A4/A3. Në qendër vendoset emërtimi i katit, në anën e majtë sipër, orientimi gjeografik (veriu), i cili duhet të përkojë me orientimin e paraqitur në genplan.

b) Modeli i planimetrisë përbëhet nga katër rubrika.

i) Rubrika e parë përmban paraqitjen grafike të planimetrisë së katit përkatës me:

1) dimensionet totale dhe të pjesshme të objektit;

2) dimensionet e brendshme;

3) kuotën e katit;

4) sipërfaqen e katit, të shtesës ose të ndarjeve funksionale.

Në rastin e një godine me më shumë se një funksion (banesë dhe funksion social-ekonomik), sipërfaqet e tyre duhet të paraqiten grafikisht të dallueshme nga njëra-tjetra.

ii) Në rubrikën e dytë paraqitet:

1) numri i dosjes së vetëdeklarimit;

2) numri i fletës;

3) shkalla e planimetrisë;

4) data e hartimit.

iii) Në rubrikën e tretë jepen:

1) të dhënat e objektit;

2) emërtimi i fletës;

3) adresa e plotë e objektit;

4) emri, atësia dhe mbiemri i poseduesit të objektit.

iv) Në rubrikën e katërt përcaktohet:

1) njësia e qeverisjes vendore (komuna/bashkia) në territorin e së cilës ndodhet objekti dhe në krah vula e saj;

2) emri, mbiemri dhe nënshkrimi i hartuesit, numri licencës (në rastin kur hartuesi është subjekt privat);

c) shkrimi i përdorur në modelet grafike bashkëngjitur këtij manuali, të jetë "Arial".

5. Hartimi i materialeve grafike për qytetin e Tiranës

Për qytetin e Tiranës materialet grafike do të hartohen nga:

a) Bashkia e Tiranës, për shtesat pa leje mbi objektet me leje ndërtimi nga KRRT/KRRTSH-ja;

b) Njësitë bashkiake, për zonat/vendbanimet/bllokbanimet/ndërtimet informale të veçuara dhe territore të tjera, si dhe për shtesat pa leje mbi ndërtimet para vitit 1993.

6. Mënyra e administrimit dhe e ruajtjes së materialeve grafike (genplanit dhe planimetrisë)

a) Vizatimet për genplanin dhe planimetrinë do të hartohen në një nga programet dixhitale të vizatimit teknik (mundësisht në një nga variantet e AUTOCAD-it).

b) Materialet grafike ruhen në CD në tri kopje, dy prej të cilave përcillen në Drejtorinë e Përgjithshme dhe në drejtorinë rajonale përkatëse të ALUIZNI-t.

7. Materialet e hartuara (genplani dhe planimetritë) janë pjesë e dokumentacionit tekniko-ligjor të domosdoshëm për pajisjen me leje legalizimi dhe për regjistrimin fillestar.

8. Në rastet kur njësia e qeverisjes vendore, nuk ushtron përgjegjësitë për shkaqet e parashikuara, kompetencat e njësisë së qeverisjes vendore me vendim të Këshillit të Ministrave, i kalojnë ALUIZNI-t, sipas pikës “d” të nenit 4 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.

GEN PLAN

Emërtimi sipas KRRT/KRRTRSH: _____

NR DOSJES SË VETDEKLARIMIT: _____

BASHKIA / KOMUNA _____

HARTOI: _____
emër mbiemër

Data: __/__/20__

PËR NJËSINË E QEVERISJES VENDORE

_____ emër mbiemër nënshkrimi vula

IDENTIFIKIMI I PASURISË: _____

ZONA KADASTRALE: _____

NR. PASURISË: _____

INDEKSI I HARTËS: _____


SHKALLA 1: 500

ADRESA E PASURISË: Qarku: _____
Q/F _____ RR/L _____
P/G _____ SH _____ K _____ AP _____

SIPËRFAQJA E PARCELËS NDËRTIMORE _____ M2

SIPËRFAQJA E NDËRTIMIT _____ M2

POSEDUESI: _____ emër mbiemër nënshkrimi vula



KUFITARËT:

VERI: _____

JUG: _____

LINDJE: _____

PERËNDIM: _____

LEGJENDA:

----- KUFIRI I PARCELËS

▨ PARCELA NDËRTIMORE

▤ OBJEKTI

PËR DREJTORINË RAJONALE TË ALUIZNI-T:

PËR SEKTORIN E HARTOGRAFISË: _____ emër mbiemër nënshkrimi vula

DREJTORI: _____ emër mbiemër nënshkrimi vula

GEN PLAN

Emërtimi sipas KRRT/KRRTRSH: _____

NR DOSJES SË VETDEKLARIMIT: _____

BASHKIA / KOMUNA _____

HARTOI: _____
emër mbiemër

Data: __/__/20__

PËR NJËSINË E QEVERISJES VENDORE

_____ emër mbiemër nënshkrimi vula

IDENTIFIKIMI I PASURISË:

ZONA KADASTRALE: _____

NR. PASURISË: _____

INDEKSI I HARTËS: _____

SHKALLA 1: 500

ADRESA E PASURISË: Qarku: _____


Q/F _____ RR/L _____

P/G _____ SH _____ K _____ AP _____

SIPËRFAQJA E PARCELËS NDËRTIMORE _____ M2

SIPËRFAQJA E NDËRTIMIT _____ M2

POSEDUESI: _____ emër atësisë mbiemër



KUFITARËT:

VERI: _____

JUG: _____

LINDJE: _____

PERËNDIM: _____

LEGJENDA:

--- KUFIRI I PARCELËS

 PARCELA NDËRTIMORE

 OBJEKTI


PËR DREJTORINË RAJONALE TË ALUIZNI-T:

PËR SEKTORIN E HARTOGRAFISË:


_____ emër mbiemër nënshkrim

DREJTORI:

_____ emër mbiemër nënshkrim vula




PLANIMETRIA E KATIT TË DYTE



Sip. ndërtimi _____ m²
 (Sip. shtesës _____ m²)
 (Sip. banimi _____ m² + Sip. funks. soc-eko. _____ m²)

Nr. dosjes vetdeklarimit:	Objekti: GODINË 3 KATE BANIMI	Komuna/Bashkia:	Vula e nj.q.v.:
Nr. fletës: A - 2 / 3	Emërtimi i fletës: PLANIMETRIA E KATIT PËRDHE	për njësinë e qeverisjes vendore: Ark./Ing. Emër Mbiemër	nënshkrimi:
Shkalla: 1 : 100	Adresa e objektit: Q/F _____, RR/L _____, P/G _____, K _____, Ap _____	punoi: Ark./Ing. Emër Mbiemër	licenca nr: A 000/0
Data: 15/02/2007	Poseduesi: Emër, Atësia, MBIEMËR		



PLANIMETRIA E KATIT _____

Nr. dosjes vetdeklarimit:	Objekti:	Komuna/Bashkia:	Vula e nj.q.v.:
Nr. fletës: A - 0 / 0	Emërtimi i fletës: PLANIMETRIA E KATIT _____		
Shkalla: 1 : 100	Adresa e objektit: Q/F _____, RR/L _____, P/G _____, K _____, Ap _____	për njësinë e qeverisjes vendore: Ark./Ing. Emër Mbiemër	nënshkrimi:
Data: __/__/200__	Poseguesi: Emër, Atësia, MBIEMËR	punoi: Ark./Ing. Emër Mbiemër	liçenca nr:

VENDIM
Nr.9, datë 9.3.2006

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të përbëra nga:

Thimjo Kondi	Kryesues
Nikoleta Kita	Anëtare
Ardian Dvorani	Anëtar
Agron. A. Lamaj	Anëtar
Perikli Zaharia	Anëtar
Artan Hoxha	Anëtar
Besnik Imeraj	Anëtar
Fatos Lulo	Anëtar
Shpresa Beçaj	Anëtare
Ylvi Myrtja	Anëtar
Irma Bala	Anëtare
Spiro Spiro	Anëtar

në seancën gjyqësore të datës 9.3.2006, morën në shqyrtim çështjen civile që i përket pjesëmarrësve në proces:

PADITËS: IGRI SINANAJ, përfaqësuar nga Av. Dashamir Kore.

E PADITUR: DREJTORIA E BUJQËSISË DHE E USHQIMIT, (DBU) FIER, përfaqësuar nga Av. Abaz Deda.

PERSONA TË TRETË: HARRILLA SEMINI

AGJENCIA KOMBËTARE E PRIVATIZIMIT (A.K.P.), e papërfaqësuar me avokat.

ME OBJEKT: Detyrimin e palës së paditur për pagimin e shumës 61 317 000 lekë.

BAZA LIGJORE: Neni 106 e vijues i Kodit Civil.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr.1130, datë 9.7.2003 ka vendosur

- *Rrëzimin e kërkesëpadisë së paditësit.*

Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr.150, datë 13.4.2004, ka vendosur:

- *Ndryshimin e vendimit të mësipërm dhe duke e gjykuar çështjen në fakt, pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë.*

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.-, datë 11.1.2006, ka vendosur:

- *Kalimin e çështjes në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për unifikimin e praktikës gjyqësore, për sa më poshtë:*

- *Çfarë do të kuptohet me “cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen”, po me cilësimin e tyre nga gjykata “pa u lidhur me përcaktimin e palëve”?*

- *Ku dallon “cilësimi i saktë i fakteve dhe veprimeve” nga “baza juridike e padisë”, kjo dhe në kuptim të urdhrit ndalues për mosndryshimin e saj pa kërkesë të palës, sipas nenit 16/2 të Kodit të Procedurës Civile.*

- *Si duhet interpretuar kjo dispozitë në lidhje me parashikimet e nenit 185 të Kodit të Procedurës Civile për kuptimin dhe ndryshimin e “shkakut ligjor të padisë” dhe “objektit të padisë”. Po në lidhje me kuptimin dhe zbatimin e elementeve të tilla të kërkesëpadisë, si “përcaktimi i objektit të padisë”, “tregimi i fakteve, rrethanave dhe së drejtës mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia”, si dhe lidhur “kërkimin e paditësit” të parashikuara në nenin 154 të Kodit të Procedurës Civile.*

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjuan relatimin e çështjes nga gjyqtari Agron. A. Lamaj dhe gjyqtarja Nikoleta Kita,

dëgjuan pretendimet e palës së paditur, e cila kërkoi pranimin e rekursit, përfaqësuesin e paditësit, i cili kërkoi rrëzimin e rekursit, si shqyrtoi dhe bisedoi në tërësi çështjen,

VËREJNË:

Vendimi nr.150, datë 13.4.2004 i Gjykatës së Apelit Vlorë, në të cilin është ndryshuar vendimi nr.1130, datë 9.7.2003 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe është pranuar pjesërisht padia e paditësit Igri Sinani, është i pabazuar në ligj, prandaj duhet të priset dhe të lihet në fuqi vendimi i gjykatës së shkallës së parë i cili e ka zgjidhur drejt çështjen duke rrëzuar padinë.

Gjatë gjykimit në gjykatën e faktit rezultojnë faktet dhe rrethanat si më poshtë:

Në vitin 1994 ish-Agjencia e Ristrukturimit të Ndërmarrjeve Bujqësore, dega Fier, ka nxjerrë për shitje, ndër të tjera, edhe objektin e quajtur “Sera nr.5”, të ndodhur në Sheq të Vogël, Fier. Me kontratën e shitjes datë 1.2.1994 agjencia e përmendur më sipër, me cilësinë e palës shitëse, ua ka shitur këtë objekt blerësve Arben Malaj dhe Ajaz Hoxha. Pas tërheqjes së këtij të fundit, kur mësoi se për truallin e objektit kishin pretendime ish-pronarët, mbetet blerës i vetëm Arben Malaj. Çmimi i objektit ishte përcaktuar 1 830 000 lekë, nga të cilat 1 330 000 lekë në formën e bonove të privatizimit dhe 500 000 lekë.

Më pas, në datën 11.2.1994 blerësi Arben Malaj kryen veprimin e dhurimit të objektit në favor të Igri Sinanit, paditës në këtë gjykim, i cili rezulton të ketë paguar ndaj shitësit pjesën e mbetur të papaguar nga çmimi i objektit.

Me vendimin nr.611, datë 27.4.1999, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur pranimin e padisë së ish-pronarëve të truallit të objektit duke konstatuar pavlefshmërinë e kontratës së shitjes në favor të blerësit Arben Malaj dhe të kontratës së dhurimit në favor të pranuesit Igri Sinani, si dhe rrëzimin e kundërpadisë së të paditurit Igri Sinani për anulimin e vendimit të Komisionit të Pronave që i kish njohur të drejtën e pronësisë dhe të parablerjes së objektit ish-pronarit të truallit.

Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë ka marrë përfundimisht formë të prerë me vendimin nr.250, datë 12.5.2000 të Gjykatës së Apelit Vlorë. Me vendimin nr.28, datë 29.6.2000 të kësaj gjykate është interpretuar vendimi i mësipërm duke vendosur përfundimisht detyrimin e Igri Sinanit t'i dorëzojë AR të NB-ve Fier objektin “Sera nr.5” dhe detyrimin e AR të NB-ve t'i kthejë Igri Sinanit shumën e paguar nga blerësi Arben Malaj për privatizimin e këtij objekti.

Me kërkesëpadinë e re objekt të këtij gjykimi, paditësi Igri Sinani ka kërkuar detyrimin e palës së paditur, drejtoria e bujqësisë Fier për t'i shpërblyer shumën prej 61 317 000 lekë si shpenzime të kryera për objektin e blerë, duke iu referuar nenit 106 e vijues të Kodit Civil.

Në këtë gjykim është thirrur si person i tretë për t'u bashkuar me palën e paditur edhe AKP, së cilës i kanë kaluar të drejtat dhe detyrimet e ARNB-ve.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur rrëzimin e padisë, me arsyetimin se padia e bazuar në nenin 106 të Kodit Civil i përket gjykimit të mëparshëm, që ka përfunduar me vendim të formës së prerë, ndërkohë që ky gjykim duhet të përqendrohet brenda kuadrit të bazës juridike të padisë, të cilën gjykata nuk mund ta ndryshojë pa kërkesën e palës. Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë në vendimin e saj shprehet se paditësi nuk mundi t'i provonte pretendimet e tij për shpenzimet, pasi faturat e paraqitura prej tij nuk janë formuluar sipas ligjit dhe nuk janë të dokumentuara në organet tatimore për pagimin e TVSH-së.

Gjykata e apelit ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë, duke detyruar drejtorinë e bujqësisë dhe të ushqimit Fier t'i kthejë paditësit Igri Sinani shumën prej 40 230 969 lekë që përbën vlerën e shpenzimeve të nevojshme të kryera prej tij në serën nr.5 nga momenti i privatizimit deri në datën 25.3.2003. Për sa më lart, gjykata e apelit në vendimin e saj, ndër të tjera, arsyeton si më poshtë:

« ... Kështu, duke iu referuar pretendimeve të ngritura prej paditësit në padi dhe gjatë gjykimit, ka dalë e shprehur qartë natyra juridike e mosmarrëveshjes në gjykim. Paditësi, në cilësinë e poseduesit të sendit, ka kërkuar kthimin e shpenzimeve të kryera prej tij për vënien në përdorim të serës nr.5. Si objekti i padisë, pra ajo që kërkohet, ashtu dhe shkaku i padisë, pra e drejta e pretenduar dhe gjendja e faktit, janë shprehur qartë prej paditësit. Veç kësaj, rezulton të jetë zhvilluar hetim gjyqësor duke marrë, administruar dhe shqyrtuar prova të paraqitura prej palëve dhe kryesisht prej vetë gjykatës. Në rrethana të tilla, nuk mund të vendosej rrëzimi i padisë. Sipas nenit 126

paragrafi i I i Kodit të Procedurës Civile, “vendimi përfundimtar jepet nga gjykata në përfundim të gjykimit i cili zgjidh çështjen në themel”. Sa më sipër, gjykata me vendimin përfundimtar duhet të vendosë rrëzimin e padisë, vetëm pasi të ketë shqyrtuar në tërësi pretendimet e ngritura në padi, t'i ketë analizuar ato në raport me provat e administruara dhe me normat juridike, dhe në përfundim të këtij procesi, të ketë arritur në konkluzionin se ato pretendime gjenden të pabazuara. Në rastin në gjykim, vendimi përfundimtar për rrëzimin e padisë, nuk rezulton të jetë rrjedhojë e këtij procesi. Referenca jo e plotë e padisë në ligjin material, nuk mund të përbëjë shkak për rrëzimin e padisë. Është detyrim i gjykatës i rrjedhur nga përmbajtja e nenit 16 të Kodit të Procedurës Civile që të bëjë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët ...».

Në kundërshtim me arsyetimin e mësipërm të gjykatës së apelit, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë e vlerësojnë të pabazuar në ligjin procedural vendimin e apelit dhe shprehen për prishjen e këtij vendimi, si dhe për lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë me plotësimin e arsyetimit të tij. Është e vërtetë se, sipas nenit 16 të Kodit të Procedurës Civile, është detyrim i gjykatës që të bëjë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët.

Mirëpo, gjykata e apelit nuk ka bërë një citim të saktë e të plotë të nenit 16 të Kodit të Procedurës Civile, dhe, për më tepër, nuk e ka interpretuar drejt këtë dispozitë.

Neni 16 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se: «Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj. Ajo bën një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët. Megjithatë, gjykata nuk mund të ndryshojë bazën juridike të padisë pa kërkesën e palës». Është pikërisht përmbajtja e paragrafit të dytë të dispozitës së mësipërme që lihet mënjanë dhe nuk përmendet nga gjykata e apelit. Duke iu referuar shprehjes “Gjykata bën një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët”, të paragrafit të parë, dhe shprehjes “Gjykata nuk mund të ndryshojë bazën juridike të padisë pa kërkesën e palës”, të paragrafit të dytë, në pamje të parë të krijohet përshtypja se dy paragrafët paraqesin përcaktime kontradiktore me njëri-tjetrin. Megjithatë, kjo nuk është e vërtetë. Nga prezantimi i fakteve dhe rrethanave të çështjes nga secila palë (në padi, në prapësimet substanciale, apo në kundërpadi), gjykata krijon idenë e saj rreth natyrës së marrëdhënies juridike për shkak të së cilës ka lindur mosmarrëveshja midis palëve, d.m.th. me fjalë të tjera, pavarësisht nga përcaktimi që propozojnë palët për cilësimin juridik të fakteve (ngjarjeve apo veprimeve), gjykata e qartëson vetë veten rreth cilësimit juridik të tyre. Mirëpo, bazën juridike të padisë e përcakton vetë paditësi në përmbajtjen e kërkesëpadisë duke bërë referencën përkatëse në dispozitën (dispozitat) konkrete të ligjit material. Të dyja këto elemente shërbejnë që gjykata të qartësojë natyrën e marrëdhënies juridike për shkak të së cilës ka lindur konflikti midis palëve. **Si përfundim në kuptim të nenit 16 të Kodit të Procedurës Civile, cilësimi i saktë i fakteve dhe veprimeve (më saktë i ngjarjeve dhe veprimeve që përbëjnë fakte juridike) që lidhen me mosmarrëveshjen bëhet nga gjykata që shqyrton çështjen, ndërsa përcaktimi i bazës juridike të padisë bëhet nga vetë paditësi, që me paraqitjen e padisë dhe është në disponimin e plotë të tij ta ndryshojë atë deri në përfundim të hetimit gjyqësor, duke i bërë kërkesë gjykatës në një formë të përshtatshme procedurale.**

Nga ana tjetër, në respekt të parimit të ruajtjes së paanësisë në gjykim, gjykata, e cila ka konkluduar në një cilësim juridik të fakteve të çështjes, të ndryshëm nga cilësimi që u ka bërë atyre paditësi nëpërmjet referencës në dispozitën përkatëse të ligjit material, nuk ka të drejtë të imponohet duke ndërhyrë e ndryshuar bazën juridike të padisë së përcaktuar nga paditësi. Në gjykimin civil gjykata nuk ka dhe nuk mund të ketë rol aktiv.

Në nenin 185 të Kodit të Procedurës Civile tërheq vëmendjen përdorimi i termit “shkaku ligjor i padisë”, krahas termit “objekti i padisë”.

Doktrina e së drejtës procedurale civile i ka definuar qartë këto dy elemente kryesore të një padie. Shkaku është arsyeja e kërimit gjyqësor, i cili ndahet në të drejtën dhe në një gjendje fakti

që është kundër kësaj të drejte (*causa pretendi*), d.m.th. që e shkel, e cenon apo e mohon të drejtën subjektive të paditësit. Nga ana tjetër, objekti është ajo që kërkohet si efekt i padisë, d.m.th. zbatimi i ligjit dhe fitimi i asaj çfarë kërkohet e që vjen si pasojë e zbatimit të ligjit (*petitum*).

E drejta subjektive e pretenduar e paditësit dhe e përcaktuar prej tij në padi, si pjesë përbërëse e shkakut të padisë, në kuptim të nenit 185 të Kodit të Procedurës Civile, është e njëjtë me bazën juridike të padisë (cilësimin juridik të bërë nga paditësi), në kuptim të nenit 16/1 të Kodit të Procedurës Civile.

Në rastin në shqyrtim paditësi ka përcaktuar si bazë juridike të padisë së tij nenin 106 të Kodit Civil, në të cilin pretendon se bazohet e drejta e tij subjektive që kërkon të mbrojë. Në vazhdim të gjykimit nuk haset ndonjë kërkim i paditësit për të ndryshuar këtë bazë juridike të padisë të përcaktuar prej tij.

Gjykata e apelit në vendimin e saj shprehjet se referenca jo e plotë e padisë në ligjin material nuk mund të përbëjë shkak për rrëzimin e padisë. Kjo është e vërtetë, por, po t'i referohemi çështjes në shqyrtim, vërejmë se referenca në nenin 106 e vijues të Kodit Civil nuk është thjesht një referencë jo e plotë. Kjo është një referencë e gabuar e cila as nuk plotësohet e as nuk ndreqet me referencë në nenet vijues të atij kapitulli. Ndërsa paragrafi i parë i nenit 106 të Kodit Civil, parashikon si pasojë të pavlefshmërisë së veprimit juridik që vjen në kundërshtim me ligjin kalimin e gjithëçkaje në të ardhurat e shtetit, gjë që nuk është kërkim i paditësit, paragrafi i dytë parashikon shprehimisht se: “Kur njëra nga palët ka vepruar në mirëbesim, gjykata mund të vendosë që çdo gjë që ka dhënë kjo palë t'i kthehet asaj dhe kur nuk është e mundur kthimi i po kësaj gjëje, i paguhet vlefja e saj”.

Rezulton qartë se dispozitat e tjera pasuese të këtij kapitulli rregullojnë problematika të tjera, që s'kanë të bëjnë me çështjen në shqyrtim. Në këtë çështje, sipas bazës juridike që ka përcaktuar paditësi, e që nuk është ndryshuar prej tij, mund të realizohet vetëm e drejta e tij që, si subjekt me mirëbesim, t'i kthehet ajo që ka dhënë nëpërmjet kryerjes së veprimit juridik absolutisht të pavlefshëm. Mirëpo kjo e drejtë rezulton të jetë kërkuar në gjykimin e mëparshëm, që ka përfunduar me vendim të formës së prerë. Po t'i referohemi kërkesëpadisë së çështjes në shqyrtim, në referencë të nenit 106/2 e vijues të Kodit Civil, paditësi kërkon vlerën e shpenzimeve të kryera në serën dhe vlerën e re të objektit pas zhvlerësimit të lekut që nga viti 1993 e deri më sot, gjë që, sipas paditësit, duhej të merrej në konsideratë nga gjykata. Në lidhje me këtë kërkim çdokush mund të shtrojë pyetjen se nga cila gjykatë mund të shqyrtohej e të zgjidhej ai.

Është e qartë që sa më lart ka përbërë shkakun dhe objektin e padisë që ka përfunduar me vendim të formës së prerë në gjykimin e mëparshëm. Ky vendim, për bazueshmërinë e të cilit mund të ketë pretendime të ndryshme, nuk mund t'i nënshtrohet asnjë lloj revizionimi në këtë gjykim të ri.

Në këtë gjykim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për efekt të unifikimit të praktikës gjyqësore, është kërkuar të sqarohet edhe kuptimi i termave “përcaktimi i objektit të padisë” “tregimi i fakteve, rrethanave dhe i së drejtës mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia” dhe “kërkimi i paditësit” të përdorura në nenin 154 të Kodit të Procedurës Civile. Për sa më lart Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë konkludojnë se:

1. «Tregimi i fakteve dhe rrethanave mbi të cilat mbështetet padia», sipas përcaktimit të bërë në nenin 154 të Kodit të Procedurës Civile, i shërben gjykatës për “të bërë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen», në kuptim të nenit 16/1 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe për përcaktimin e gjendjes së faktit që i kundërvihet së drejtës subjektive të paditësit, që është pjesë përbërëse e shkakut të padisë, në kuptim të nenit 185 të Kodit të Procedurës Civile.

2. «Tregimi i së drejtës mbi të cilën mbështetet kërkesëpadia», në kuptim të nenit 154 të Kodit të Procedurës Civile, i korrespondon së drejtës subjektive të paditësit si pjesë përbërëse të “shkakut të padisë” në kuptim të nenit 185 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe të përcaktimit “të bazës juridike të padisë” në kuptim të nenit 16/2 të Kodit të Procedurës Civile.

3. Përcaktimi i “kërkimit të paditësit” në kërkesëpadi në kuptim të nenit 154 të Kodit të Procedurës Civile, i korrespondon asaj çfarë kërkohet të fitohet si pasojë e zbatimit të ligjit, në kuptim të përcaktimit të objektit të padisë, parashikuar në nenin 185 të Kodit të Procedurës Civile.

Në përfundim, mund të theksojmë se neni 154 i Kodit të Procedurës Civile përcakton në mënyrë analitike elementet përbërëse të kërkesëpadisë si mjeti procedural që vë në lëvizje gjykatën për fillimin e gjykimit të një çështjeje civile. Një kërkesëpadi që nuk i plotëson këto elemente të

domosdoshme është e papranueshme për t'iu nënshtruar shqyrtimit gjyqësor, prandaj i kthehet paditësit për t'u plotësuar në respektim të rregullave procedurale.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në respektim të nenit 141 të Kushtetutës, nenit 485/b të Kodit të Procedurës Civile, nenet 14/c dhe 17/a të ligjit nr.8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSËN:

1. Prishjen e vendimit nr.150, datë 13.4.2004 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe lënien në fuqi të vendimit nr.1130, datë 9.7.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.
2. Ky vendim për njësim të praktikës gjyqësore të dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Ne gjyqtarët në pakicë jemi të mendimit se vendimi nr.150, datë 13.4.2004 i Gjykatës së Apelit Vlorë është i mbështetur në ligj dhe si i tillë duhet të mbetet në fuqi.

Përfundimet e arritura për efekt të unifikimit të praktikës gjyqësore në vendimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nuk kanë ezauruar qëllimin dhe problematikën e çështjeve të vëna në bisedim në këtë gjykim për efekt unifikimi, përse i përket kuptimit juridik, sistematik dhe të harmonizuar, të termave dhe çështjeve që kanë të bëjnë me “cilësimin e saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen” “pa u lidhur me përcaktimin e palëve”, “bazën juridike të padisë”, “të drejtën”, përcaktimet lidhur me “shkakun ligjor” dhe “objektin e padisë” etj., në procesin gjyqësor civil. Ndërkohë që në praktikën tonë gjyqësore vërehen qëndrime konfuze lidhur me shkakun ligjor të padisë, ngatërrimin apo njëjtësimin e saj me *“referencat ligjore”* konkrete sikurse formulohen sot kërkesëpaditë me të ashtuquajturën *“bazë ligjore”*, etj. Pra, jemi përpara një situatë të krijuar në praktikë kur, me kalimin e kohës, në mënyrë automatike, palët dhe gjykatat të mos mbajnë më parasysh dallimin e qartë të kuptimit dhe zbatimit të këtyre nocioneve e termave të procesit gjyqësor civil, gjë që ka sjellë edhe pasiguri në pozicionimin, kërkimet, prapësimet dhe qëndrimet e palëve e të gjykatës gjatë gjykimit dhe në dhënien e vendimit.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë vendosur prishjen e vendimit nr.150, datë 13.4.2004 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe lënien në fuqi të vendimit nr.1130, datë 9.7.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier që rrëzonte padinë. Pikërisht, jemi të mendimit se edhe për shkak të trajtimit jo të plotë dhe pasaktësive në përfundimet unifikuese të saj, Kolegjet e Bashkuara, në zgjidhjen e çështjes, janë mbështetur në arsyetimin se, ndryshe nga sa ka arsyetuar e vendosur gjykata e apelit, *“referenca ligjore”* e treguar në padi (neni 106 e vijues i Kodit Civil) nuk është thjesht një *referencë* “jo e plotë por është e gabuar” dhe, si e tillë, “... nuk plotësohet dhe as nuk ndreqet me referencë në nenet vijuese të atij kapitulli”. Prandaj, Kolegjet e Bashkuara, konkludojnë se “në këtë çështje, sipas bazës juridike që ka përcaktuar paditësi, e që nuk është ndryshuar prej tij, mund të realizohet vetëm e drejta e tij që, si subjekt me mirëbesim, t’i kthehet ajo që ka dhënë nëpërmjet kryerjes së veprimit absolutisht të pavlefshëm”. Sipas Kolegjeve të Bashkuara: *“Është e qartë se sa më lart ka përbërë shkakun dhe objektin e padisë që ka përfunduar me vendim të formës së prerë në gjykimin e mëparshëm”*.

Në vijim, ne gjyqtarët në pakicë jemi të mendimit se qëndrimi i shumicës në Kolegjet e Bashkuara në zgjidhjen e çështjes objekt i këtij gjykimi nuk i korrespondon edhe vetë përfundimeve unifikuese të arritura po prej saj në këtë vendim në lidhje me kuptimin dhe zbatimin e dispozitave ligjore mbi “objektin” dhe “shkakun ligjor” të padisë, “bazën juridike”, “të drejtën”, si dhe “për cilësimin e saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen”.

Në kuptim dhe interpretim të normave materiale e procedurale civile, ne gjyqtarët e pakicës jemi të mendimit **se “baza ligjore”, apo “referenca” në dispozitën konkrete ligjore, të formuluar në kërkesëpadi, nuk përbëjnë element thelbësor dhe përcaktues të padisë në kuptimin material e procedural të saj. Aq më tepër, këto nuk mund të barazohen me nocionin klasik juridiko-civil të**

“shkakut ligjor” të padisë.

Elemente thelbësore dhe përcaktuese të padisë për shqyrtimin dhe dhënien e vendimit janë: gryketa ku drejtohet padia, identiteti dhe pozita e palëve ndërgryqëse, objekti i padisë dhe shkaku ligjor ku mbështetet padia.

Lidhur me padinë, në ushtrimin e së drejtës për ngritjen e saj në grykatë, për paditësin duhet të ekzistojë dhe të tregohet prej tij e drejta për të kërkuar atë që përmbahet në objektin e padisë, e drejtë e cila mbrohet nga një normë abstrakte e së drejtës pozitive (ligji). Në rast se objekti dhe shkaku ligjor i padisë, pra ajo që kërkohet me padi, janë treguar qartë dhe grykata çmon se është e përcaktuar natyra e mosmarrëveshjes, por “referenca ligjore” (apo e ashtuquajtura “baza ligjore” e padisë), si dhe cilësimi juridik i fakteve nga paditësi, adresohen gabimisht apo pamjaftueshmërisht në një dispozitë konkrete ligjore që nuk duket të ketë lidhje me kërkimet e padisë, pikërisht këtë mangësi, këtë “rregullim”, pra edhe “cilësim të saktë” juridik të “fakteve” në kuptim të nenit 16 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, duhet ta bëjë grykata gjatë shqyrtimit gryqësor të çështjes. Grykata fillon shqyrtimin e padisë dhe zgjidh mosmarrëveshjen jo duke u mbështetur në dispozita konkrete të ligjit (“bazën ligjore”) që tregohen nga palët në kërkimet e tyre, por në ato dispozita të së drejtës abstrakte (ligjës) që në grykim asaj do t’i rezultojnë se objektivisht përcaktojnë të drejtën e zbatueshme në këtë mosmarrëveshje, dispozita që janë të detyrueshme për grykatën. **Prandaj konkludohet se kemi të bëjmë me një të drejtë dhe njëkohësisht detyrim të grykatës për të grykuar dhe dhënë vendimin e saj mbështetur jo thjesht në “të drejtën” por në dispozitat përkatëse, konkrete, të ligjës që lidhen me mosmarrëveshjen.**

Në grykimin civil, pala që ngre një pretendim ka detyrimin të parashtrojë dhe të vërtetojë ekzistencën e faktit krijues dhe të së drejtës ku ajo mbështet pretendimin (kërkimin), si dhe të manifestojë vullnetin, kërkesën e saj, që të përfitojë nga fakti krijues dhe e drejta, pa qenë e domosdoshme që të tregojë saktësisht “dispozitën ligjore” ku gjen mbështetje konkrete kjo e drejtë. Identifikimi, përcaktimi i kësaj norme konkrete është një e drejtë dhe njëkohësisht detyrim i grykatës, në përfundim dhe si rezultat i zhvillimit të grykimit sipas parimit të kontradiktorialitetit lidhur me pretendimin e ngritur në padi. **Prandaj, nisur edhe nga zbatimi i parimit të disponibilitetit, është detyrim i palës që, në mënyrë pohuese dhe jo dyshuese (p.sh. për mungesën e tyre), të formulojë kërkesëpadinë në një formë të përshtatshme, por në përmbajtje në mënyrë të qartë dhe të dallueshme, për kërkimet e saj lidhur me faktet, arsyet, të drejtën, në të cilat mbështetet padia që ka ngritur përpara grykatës.**

Për këto arsye, pakica ka mendimin që për përmbajtjen e nenit 16 të Kodit të Procedurës Civile, në harmoni me normat e tjera që lidhen me çështjet objekt i këtij grykimi, interpretimi i saktë i ligjës kërkon të pranohet edhe se për individualizimin e përmbajtjes së kërkimeve në padi, grykata nuk duhet të mjaftohet dhe të kufizohet vetëm në kuptimin, shqyrtimin letrar, “fjalë për fjalë”, të kërkimeve ashtu siç janë formuluar në kërkesëpadi (e njëjta gjë edhe për prapësimet, mjetet e ankimit etj.). Ajo duhet të verifikojë ekzistencën dhe konkretisht atë që përbën vullnetin e palës, duke iu referuar fakteve dhe argumenteve që pala ka parashtruar, si dhe qëllimit që ajo synon të arrijë, të kuptueshme këto dhe për të cilat mund të konkludohet edhe nga vetë natyra e kufijtë e padisë së ngritur, nga pozita ku janë vendosur, si dhe qëndrimet përkatëse të palëve në fillim dhe gjatë shqyrtimit gryqësor të çështjes.

Jemi të mendimit se interpretimi i saktë i nenit 16/2, apo edhe 185 të Kodit të Procedurës Civile janë të lidhur në veçanti me një nga parimet e grykimit civil që përmbahet në nenin 6 të Kodit të Procedurës Civile: “Grykata që grykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet”. Kjo dispozitë i ndalon grykatës që t’i njohë një pale një të drejtë që ajo nuk e ka kërkuar ose të japë një vendim që nuk i korrespondon një kërkimi të palës. Këto raste do të përbënin një ndërhyrje të pambështetur ligjërisht nga ana e grykatës në disponibilitetin e palëve ndërgryqëse, ndërhyrje që në këtë mënyrë do të ndryshonte, tjetërsonte, elemente objektive të vetë kuptimit dhe ekzistencës së padisë, në këtë rast, të objektit dhe shkaku ligjor të saj (“petitum” dhe “causa petendi”). Rrjedhojë e këtij qëndrimi të grykatës mund të jetë edhe mohimi i së drejtës së kërkuar në grykatë nga pala. Në të njëjtën situatë paligjshmërie, sipas mendimit tonë, grykata do të ndodhet edhe atëherë kur, ndonëse shprehet brenda objektit të padisë, merr në shqyrtim e çmon kryesisht një prapësim që kundërshton të drejtën që kërkohet të mbrohet me padi nga ana e paditësit, ose në rastin kur grykata vendos në themelin e vendimit të saj, fakte dhe rrethana jashtë objektit të grykimit, të cilat përbëjnë një titull, shkaku ligjor (“causa petendi”)

të ri dhe të ndryshëm nga ajo që ka disponuar dhe pretenduar paditësi.

Nga ana tjetër, nisur nga roli e gjykatës në gjykimin civil, në interpretim të nenit 16 të Kodit të Procedurës Civile, jemi të mendimit se ndodhemi përpara përmbushjes së parimeve themelore të gjykimit civil, nëse gjykata jep vendim duke u mbështetur në vlerësimin e saj, të pavarur, juridik, të fakteve dhe rrethanave të çështjes që mund të jenë të ndryshme nga interpretimi e vlerësimi i tyre juridik në parashtrimet e bëra nga palët, përfshirë këtu mbështetjen e zbatimit e një norme juridike konkrete të ndryshme nga ajo (e ashtuquajtura “baza” apo “referenca” ligjore) që mund të jetë treguar nga pala që ka bërë kërkimin (apo prapësimin, ankimin, etj.). Pra, gjykata nuk shkel, përkundrazi, zbaton me korrektësi ligjin procedural e material, nëse vendos mbi bazën e dispozitave ligjore të ndryshme nga ato të formuluar në parashtrimin e palës, mjafton që të ketë qëndruar në arsyetimin e saj brenda objektit dhe shkakut ligjor të padisë, si elemente esenciale pa të cilat nuk fillon dhe as mund të kuptohet ekzistenca e gjykimit civil.

Gjithashtu, pakica ka mendimin se është e drejtë dhe detyrë e gjykatës të përcaktojë normën konkrete (“*nomen iuris*”) që ka të bëjë me padinë, me mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pavarësisht nga cilësimi që mund t’u kenë bërë atyre palët ndërgjyqëse. Por, nga ana tjetër, gjykata do të shkelte kufijtë ligjorë të kësaj të drejte-detyrimi të saj (“*ultra et extra petitum*”) nëse praktikisht, me vendimin e dhënë, do të zëvendësonte kërkimin e padisë me një kërkim tjetër, të ri, mbi një shkak ligjor tjetër, mbi tërësi faktesh dhe rrethanash që nuk rezultojnë të jenë biseduar nga palët gjatë gjykimit sipas parimit të kontradiktorialitetit.

Për këto arsye jemi të mendimit se është e drejtë e personit t’i drejtohet dhe të vërë në lëvizje gjykatën për mbrojtjen e një të drejte që pretendohet se i është cenuar dhe, njëkohësisht, detyrim i tij të tregojë qartësisht atë që kërkon, interesin që mbrohet nga e drejta (abstrakte) ku e mbështet pretendimin e tij. Por, nga ana tjetër, është e drejtë dhe njëkohësisht detyrë e gjykatës t’u mundësojë palëve pjesëmarrje të drejtpërdrejta dhe kontradiktorialitetin e gjykimit sipas ligjit, si dhe të japë një vendim ku parashtrohen cilësimi i saktë, i pavarur, juridik, i vetë gjykatës mbi faktet, kërkimet e prapësimet e palëve, duke treguar tashmë jo thjesht arsyen, të drejtën, që pretendohet se mbështet kërkimin e padisë, por edhe dispozitat ligjore konkrete ku ajo çmon se mbështetet vendimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Kjo është logjikë dhe e lidhur me misionin e gjykatës, e cila në veprimtarinë e saj në procesin civil synon të garantojë një proces të rregullt ligjor dhe një gjykim të drejtë (neni 42 i Kushtetutës, neni 4 i Kodit të Procedurës Civile) të finalizuar me dhënien e një vendimi përfundimtar për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, mbështetur edhe në aksiomën juridike “*iuria novit curia*”, pra është gjykata ajo që e njeh vetë ligjin dhe që vendos përfundimisht në bazë e për zbatim të tij. Kjo e fundit është edhe një nga arsyet thelbësore përse personat mund dhe duhet t’i drejtohen gjykatës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet tyre.

Sipas parimit të disponimit të palëve, atij të kontradiktorialitetit etj. “*vetëm palët mund të venë në lëvizje gjykatën*” për fillimin e një procesi gjyqësor, me anë të padisë (neni 2 i Kodit të Procedurës Civile), duke përcaktuar ato vetë edhe objektin e mosmarrëveshjes (neni 5). Këto përcaktime bëhen në padinë e parashtruar para gjykatës, por kërkimet, pra vullneti dhe qëllimi i palëve, formësohen edhe “*gjatë ushtrimit të të drejtave*” në procesin gjyqësor civil (neni 5). Është detyrë e gjykatës që të shprehet pikërisht për të gjitha kërkimet, prapësimet, mjetet e ankimit etj. të palëve dhe vetëm për ato (neni 6) në përfundim të një procesi të rregullt gjyqësor (neni 4).

Por, nga ana tjetër, ndonëse nuk ka rol aktiv në kuptim të vënies në lëvizje dhe të disponimit mbi kërkimet e padisë, prapësimet, mjetet e ankimit etj. gjykata ka disa të drejta-detyrime thelbësore në funksion të garantimit të procesit të rregullt gjyqësor dhe dhënies së vendimit. Gjykata ka të drejtën-detyrimin të ftojë palët të japin shpjegime mbi faktet që “*ajo i vlerëson të nevojshme*” për zgjidhjen e mosmarrëveshjes (neni 9), duke e zgjidhur atë “*në përputhje me dispozitat ligjore*” që është e detyruar të zbatojë, pasi të ketë bërë vetë cilësimin e fakteve pa u lidhur me përcaktimet e propozuara nga palët (neni 16). Madje, gjykata i fton palët “*të japin shpjegime*” nga pikëpamja e së drejtës që “*ajo çmon të nevojshme*” (neni 17).

Duke vepruar në këtë mënyrë, nisur nga parimi se ligjin e njeh gjykata (*iuria novit curia*), ajo ka detyrimin të shprehet mbi arsyet dhe mbështetjen ligjore konkretë të pranimit ose jo për të gjitha kërkimet në padi, brenda kufijve të objektit dhe shkakut ligjor të saj (neni 29). Por gjykatës i ndalohej të ndryshojë vetë shkakun ligjor të padisë (neni 16 paragrafi i dytë), sepse kjo përbën një disponim thelbësor, ekskluziv të paditësit, element vendimtar për ekzistencën e padisë dhe vetë gjykimit civil.

Ndërsa sipas dispozitave të neneve 154/a dhe 158/a të Kodit të Procedurës Civile gjykata ka të drejtën-detyrimin të pranojë kërkesëpadinë nëse janë plotësuar nga paditësi elementet thelbësore të saj sipas nenit 154 të këtij Kodi, duke i dhënë paditësit mundësinë që ai vetë të riparojë të metat e padisë. Sa më sipër përbën **një rol të llojit “orientues”**, por aspak **vendosës** të gjykatës, që realizohet veçanërisht në kuadër të fazës dhe veprimeve përgatitore. Ky rol i gjykatës i shërben vetëm synimit për të saktësuar, qartësuar atë që do të përbënte objektin e gjykimit të mosmarrëveshjes, në kuadër të krijimit të kushteve ligjore dhe faktike për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor për të gjitha palët ndërgjyqëse. Por mbetet gjithnjë disponim ekskluziv i paditësit që të ndryshojë objektin dhe shkahun ligjor të padisë (neni 185).

Së fundi, duke qenë se nuk është detyrim i palëve por i vetë gjykatës, nuk është e rastit që, në dallim nga dispozitat e lartpërmendura në lidhje me përmbajtjen e padisë, në nenin 310/II, pika 3 të Kodit të Procedurës Civile, asaj i kërkohet që në vendim të tregojë “dispozitat ligjore” konkrete në të cilat mbështetet vendimi i saj. Pra, ndryshe nga palët, ligjvënësi nuk e ngarkon gjykatën me detyrimin të tregojë “bazën juridike” apo “të drejtën” ku mbështetet, por pikërisht “dispozitat ligjore” konkrete të ligjës të detyrueshme për mbështetjen e vendimit të gjykatës.

Për arsyet që parashtruam më sipër, ne gjyqtarët e pakicës jemi të mendimit se Kolegjet e Bashkuara nuk kanë arritur të zgjidhin drejt edhe çështjen konkrete objekt i këtij gjykimi. Edhe në këtë çështje, ishte fakultet i palës paditëse të tregonte dispozitat konkrete të ligjit që lidhen me padinë. Por, nuk ishte as detyrim i paditësit të përcaktonte, as edhe detyrim i gjykatës që të kërkonte përcaktimin nga paditësi të këtyre dispozitave konkrete (nenet) të ligjës që lidhen me objektin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Kjo për shkak se këto të ashtuquajtura “referenca ligjore” nuk janë elemente të qenies (ekzistencës) së kërkesëpadisë. E tillë ishte vetëm tregimi i shkakut ligjor i së drejtës dhe gjendjes së faktit që i kundërvihet kësaj të drejte. Gjykatat nëse do të kishin çmuar, thjesht mund të orientonin paditësin dhe palët e tjera për sqarimin e qartësimin e kërtimeve dhe natyrës së mosmarrëveshjes për të cilën ishte ngritur padia.

Paditësi ka vendosur në objektin e padisë detyrimin e anës së paditur që t’i shpërblejë shumën prej 61 317 000 lekë si shpenzime të nevojshme dhe të dobishme të kryera nga ana e tij në “Serën nr.5” pronë e të paditurit, për shkak se kishte qenë posedues i ligjshëm dhe në mirëbesim i kësaj prone, pra përpara se kontratat e tjetërsimit të pronës në favor të tij, në një gjykim tjetër, të konstatoheshin me vendim gjyqësor si absolutisht të pavlefshme. Kjo përbën zgjedhjen, vullnetin, qëllimin e paditësit, objektin e kërimit dhe të së drejtës që ai pretendon se i është shkelur, një padi detyrimi (personale), por që trajtohet nga Kodi Civil në mjetet për mbrojtjen e pronësisë (neni 299). Pra, paditësi nuk ka kërkuar rikthimin nga ana e paditur të asaj që mund të ketë dhënë në kuadër të veprimeve juridike (kontratave të dhurimit e shitjes) të cilat janë konstatuar absolutisht të pavlefshme sipas nenit 106 të Kodit Civil, ndonëse kjo dispozitë konkrete rezulton të jetë vendosur prej tij në rubrikën “baza ligjore” të kërkesëpadisë. Nëse këto kërtime (objekt e shkak ligjor) të paditësit qëndronin apo jo, ato i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor të çështjes, në përfundim të së cilës gjykata vendos për pranimin ose rrëzimin e padisë.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, që kanë lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë kanë vendosur në themel të arsytimit dhe qëndrimit të tyre faktin se paditësi ka përdorur si “referencë ligjore”, pa e ndryshuar në proces, nenin 106 e vijues të Kodit Civil, dispozita që kanë të bëjnë me zgjidhjen e pasojave të pavlefshmërisë absolute të veprimit juridik, shkak për të cilën ka një gjykim të mëparshëm të formës së prerë. Por, sipas mendimit tonë, si gjyqtarë në pakicë, Kolegjet e Bashkuara në çështjen objekt i këtij gjykimi kanë identifikuar dhe njëjtësuar gabimisht “referencën ligjore” të bërë në padi (nenin 106 e vijues të Kodit Civil) me shkahun ligjor të padisë, të drejtën e tij si posedues në mirëbesim mbi shpenzimet e nevojshme e të dobishme të kryera mbi sendin dhe faktet që i kundërvihen kësaj të drejte.

Një qëndrim i tillë, padashur, sjell situatën kur gjykata nuk shprehet më për kërkimet e paditësit dhe brenda kufijve të tyre (e drejta e poseduesit në mirëbesim për shpenzimet sipas shumës së kërkuar në objektin e padisë dhe gjendja e faktit që i kundërvihet kësaj të drejte), por në fakt e ka ndryshuar, kryesisht, bazën juridike të padisë pa kërkesë të palës, gjë që nuk përputhet me qëndrimin, qëllimin dhe vullnetin e formësuar të paditësit edhe gjatë gjykimit lidhur me objektin dhe shkahun ligjor të padisë së ngritur prej tij. Sipas mendimit tonë, nëse në përmbajtje (jo në formë) kërkitimi (objekti dhe shkak ligjor) i padisë është i qartë, nuk ka rëndësi për fatin e çështjes fakti nëse duhet të

ekzistonte apo ndryshohej në gjykim e ashtuquajtura “referenca ligjore” konkrete në nenin 106 e vijues të Kodit Civil.

Për arsyet e mësipërme, duke qenë se për çështjet e tjera të lidhura me vlerësimin e provave janë shprehur gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit, ne gjyqtarët e pakicës jemi të mendimit se Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë duhet të linin në fuqi vendimin nr.150, datë 13.4.2004 të Gjykatës së Apelit Vlorë, që kishte ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë duke pranuar padinë, si një vendim i mbështetur në ligj.

Anëtarë: Fatos Lulo, Besnik Imeraj, Ardian Dvorani

MENDIM PARALEL

1. Paditësi ka paraqitur një kërkesëpadi, duke pretenduar se ana e paditur duhet të detyrohet t'i shpërblejë atij shumën e të hollave të shpenzuara për investimin e kryer në serën nr.5, me arsyetimin se ai ka qenë në mirëbesim, pasi ka ditur se veprimet e kryera nga organet shtetërore janë të rregullta dhe se objekti i blerë ka qenë tej mase i amortizuar.

2. Me një vendim tjetër gjyqësor (nr.611, datë 27.4.1999), mbi padinë e ngritur nga personat e tretë, është vendosur pavlefshmëria e kontratës së shitjes (për sendin objekt gjykimi), e lidhur ndërmjet ARNB Fier dhe shtetasit A.M., si dhe kontrata e dhurimit e lidhur ndërmjet këtij të fundit dhe paditësit duke u kthyer palët në gjendjen e mëparshme, d.m.th. detyrimin e paditësit t'i dorëzojë ARNB serën nr.5 dhe detyrimin e ARNB t'i kthejë paditësit shumën e paguar nga A.M. për privatizimin e serës.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, në çështjen objekt gjykimi, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, me arsyetimin se pretendimi i paditësit është detyrim i anës së paditur për shpërblim shume dhe si bazë ligjore ka përcaktuar nenin 106 të Kodit Civil. Kjo dispozitë i referohet rasteve të pavlefshmërisë së veprimit juridik, pretendim të cilin paditësi mund ta ngrinte në gjykimin e parë. Baza juridike e kërkesëpadisë, sipas pretendimit të paditësit, duhej të ishte neni 299 i Kodit Civil.

4. Gjykata e Apelit Vlorë ka ndryshuar këtë vendim dhe ka vendosur pranimin e pjesës së kërkesëpadisë me arsyetimin se si objekti i kërkesëpadisë, edhe shkaku i saj janë shprehur qartë prej paditësit. Referenca juridike jo e plotë d.m.th. përcaktimi i bazës juridike të kërkesëpadisë nuk është shkak për rrëzimin e saj, pasi është detyrimi i gjykatës të bëjë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët.

5. Neni 16 i Kodit Civil ka përmbajtjen e mëposhtme:

Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj. Ajo bën një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët. Megjithatë, gjykata nuk mund të ndryshojë bazën juridike të padisë pa kërkesën e palës.

6. Përcaktimi i mësipërm thekson parimet e rëndësishme procedurale civile që lidhen me rolin e gjykatës në një mosmarrëveshje, d.m.th. vendi i saj në raport me palët dhe me rolin e palëve, d.m.th. me marrëdhënien ndërmjet tyre dhe gjykatës, e konkretizuar në parimin e disponimit maksimal.

6.1. Vënia në lëvizje e gjykatës për fillimin e një procesi është e drejtë e vetë palës (neni 2 i Kodit të Procedurës Civile). Kjo e drejtë buron nga vetë organizimi i rendit juridik (e drejta materiale) dhe është ana procesuale e parimit të autonomisë private (individit vendos vetë mbi mënyrën e rregullimit të marrëdhënieve juridike).

Vetëm në raste përjashtimore e drejta civile procedurale i ka dhënë subjekteve të veçanta kompetenca, në zbatimin e të cilave shteti ka një interes të veçantë publik, ushtrimi i të cilave nuk është në dëshirën e individit, por mund të jetë edhe kundër tij. Kjo ndodh nëpërmjet të drejtës së prokurorit për paraqitjen e kërkesëpadisë (nenet 375, 382 të Kodit të Procedurës Civile).

6.2. Parimi i mësipërm konkretizohet në plotësimin e disa detyrimeve ligjore procedurale që ka pala që vendos të ushtrojë të drejtën e paraqitjes së padisë (neni 154 i Kodit të Procedurës Civile). Ajo ka detyrimin të vendosë ndër të tjera objektin e procesit (të kërkesëpadisë). Vetëm mbi këtë objekt gjykata ka të drejtë të shprehet, d.m.th. të vendosë. Ajo vetë nuk mund të ndryshojë këtë objekt. Ky qëndrim pasiv i gjykatës ka kuptimin: ku s'ka padi s'ka gjykatë.

Më tej paditësi ka detyrimin të përcaktojë edhe përmbajtjen e kërimit të tij. Kur paditësi nuk plotëson këto detyrime, padia e tij është e papranueshme. Kjo d.m.th. se pala ka disponimin maksimal mbi të drejtën e saj dhe gjykata është e lidhur vetëm me kërkimin që bën paditësi, d.m.th. ai s'ka të drejtë të pretendojë diçka tjetër ose tej përmbajtjes së kërkesës që ka paraqitur "*ne eat iudex ultra petita partium*".

7. Të drejtën e padisë e ka paditësi. Kjo kërkesë e tij përmban një pretendim juridik, themelësia ose jo e të cilit është detyrë e të provuarit nga ana e gjykatës. Pra, gjykata ka detyrimin të provojë që objekti i përcaktuar nga paditësi plotëson të gjitha elementet e normës juridike (të drejtës mbi të cilën mbështetet kërkesëpadia) dhe si rrjedhim të pranojë edhe një pasojë juridike që vjen nga zbatimi i saj. Ky proces është tërësisht e drejtë e gjykatës dhe pala nuk mund të ndërhyjë.

Se cila normë duhet të zbatohet, si duhet të kuptohet ajo dhe nëse fakti i paraqitur nga paditësi rregullohet nga ajo normë d.m.th. dhënia e një vendimi sipas së drejtës në fuqi është detyrë e vetme e gjykatës (neni 16 i Kodit të Procedurës Civile) "*iura novit curia*".

8. Meqenëse e drejta e dhënies së një vendimi në përputhje me ligjën është e drejtë e gjykatës, nuk mundet kjo e fundit të lidhet me pretendimet që mund të propozojnë pjesëmarrësit në proces. Gjykata për shkak të detyrës së saj, pra e pavarur nga dëshira e palëve, ka për detyrë të sqarojë objektin e mosmarrëveshjes d.m.th. të cilësojë saktë faktet, veprimet që lidhen me mosmarrëveshjen dhe të kërkojë të hetojë të gjitha provat e paraqitura lidhur me të. Ajo mban të gjithë përgjegjësinë për dhënien e një vendimi të drejtë e të bazuar (neni 29 i Kodit të Procedurës Civile). Kjo është dhe përmbajtja e parimit të së drejtës maksimale "*inquisition maxime*".

9. Në kuptim të analizës së mësipërme Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, për një kuptim të saktë të nenit 16 të Kodit të Procedurës Civile, bën unifikimin e praktikës gjyqësore si më poshtë:

Gjykata në funksion të dhënies së drejtësisë ka për detyrë të bëjë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, por ajo nuk ka të drejtë të ndryshojë bazën juridike të kërkesëpadisë. Ajo ka detyrimin të gjykojë mosmarrëveshjen e paraqitur brenda kuadrit juridik të paraqitur nga paditësi. Vetëm ky ka disponimin mbi objektin dhe bazën juridike të kërkesëpadisë.

10. Në zbatim të këtij unifikimi gjykata e apelit ka zbatuar ligjën gabim, pasi ka cenuar të drejtën e paditësit mbi disponimin e kërkesëpadisë dhe për pasojë vendimi i saj duhet të prishet dhe të lihet në fuqi vendimi i gjykatës së rrethit gjyqësor.

Anëtar: Agron A. Lamaj

VENDIM Nr.73, datë 2.11.2006

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT, PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, PËR SHOQËRINË “WTS ENERGJI” SHPK, PËR VITIN 2007

Në mbështetje të neneve 9 dhe nenit 26 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, me ndryshime, si dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 13.5.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, me ndryshimet përkatëse, neni 11 germa A, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 2.11.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “WTS Energji” sh.p.k., për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, për vitin 2007,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit, për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, për shoqërinë “WTS Energji” sh.p.k., për vitin 2007.

2. Ngarkohen Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun dhe Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve për shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga “WTS Energji” sh.p.k. për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për vitin 2007.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.74, datë 2.11.2006

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT, PËR
PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, PËR SHOQËRINË
“AMAL” SHPK, PËR VITIN 2007**

Në mbështetje të neneve 9 dhe nenit 26 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, me ndryshime, si dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 13.5.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, me ndryshimet përkatëse, neni 11 germa A, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 2.11.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “Amal” sh.p.k, për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, për vitin 2007,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit, për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, për shoqërinë “Amal” sh.p.k., për vitin 2007.

2. Ngarkohen Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun dhe Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve për shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga “Amal” sh.p.k. për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për vitin 2007.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.75, datë 2.11.2006

**PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
“JUANA” SHPK PËR PERIU DHËN 1 JANAR 2006 DERI MË 31 DHJETOR 2006**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa b; 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe vendimit nr.60, datë 29.12.2004 të Bordit të Komisionerëve “Për miratimin e të dhënave bazë në lidhje me aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga prodhuesit e vegjël”, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 2.11.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga “Juana” sh.p.k., për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për periudhën 1 janar 2006 deri më 31 dhjetor 2006,

VENDOSI:

1. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga “Juana” sh.p.k., për periudhën 1.1.2006 - 31.12.2006, të jetë 5,43 lekë/kWh.

2. Ngarkohen “Juana” sh.p.k. dhe KESH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.76, datë 7.11.2006

PËR TRANSFERIMIN E LICENCËS NGA “SARMIER” SHPK TE “PROJEKSION” SHPK

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 13, pika 1 germa a, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.15, datë 27.8.2003 dhe licencës nr.08, seria PV03P, për shfrytëzimin e centraleve elektrike dhe prodhimin e energjisë elektrike “Sarmier” sh.p.k., pika 1.3, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.11.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “Projeksion” sh.p.k., për transferimin e licencës së mbajtur nga shoqëria “Sarmier” sh.p.k. për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Më datën 16.1.2006, “Sarmier” sh.p.k. i është drejtuar ERE-s me kërkesën “Për miratimin e shitjes së hidrocentraleve Rehovë, Kolonjë me fuqi të instaluar 100 kW, Treska 1, Korçë me fuqi të instaluar 130 kW dhe Çarshovë, Përmet me fuqi të instaluar 70 kW.

- Bordi i Komisionerëve, me vendimin nr.8, datë 16.2.2006, vendosi transferimin e aseteve nëpërmjet shitjes për hidrocentralet e shoqërisë “Sarmier” sh.p.k., te shoqëria “Projeksion” sh.p.k.

- Shoqëria “Sarmier” sh.p.k. ka lidhur me shoqërinë “Projeksion” sh.p.k. kontratat e shitblerjes nr.998 Rep, nr.372 Kol, datë 21.2.2006; nr.416 Rep, nr.31 Kol, datë 23 janar 2006; dhe nr.2384 Rep, nr.990 Kol, datë 2.11.2006.

- Shoqëria “Sarmier” sh.p.k. ka lidhur me shoqërinë “Projeksion” sh.p.k. një aktmarrëveshje me nr.2965 Rep, nr.1585/1 Kol. datë 2.11.2006.

Për sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Transferimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike nga shoqëria “Sarmier” sh.p.k. te shoqëria “Projeksion” sh.p.k. për hidrocentralet Rehovë, Kolonjë, me fuqi të instaluar 100kW; dhe Treska 1, Korçë me fuqi të instaluar 130 kW, Çarshovë, Përmet, me fuqi të instaluar 70 kW.

2. Shoqëria “Projeksion” sh.p.k. mbart të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në licencën e prodhimit të energjisë elektrike, seria PV03P, nr.08, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.15, datë 27.8.2003.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.77, datë 7.11.2006

PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA “MAKSI ELEKTRIK” SHPK PËR PERIUDHËN 1 JANAR 2006 - 31 DHJETOR 2006

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa b; 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe vendimit nr.60, datë 29.12.2004 të Bordit të Komisionerëve “Për miratimin e të dhënave bazë në lidhje me aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga prodhuesit e vegjël”, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 7.11.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga “Maksi Elektrik” sh.p.k., për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për periudhën 1 janar 2006 - 31 dhjetor 2006,

VENDOSI:

1. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga “Maksi Elektrik” sh.p.k., për

periudhën 1.1.2006 deri me 31.12. 2006, të jetë 5.1 lekë/kWh.

2. Ngarkohet “Maksi Elektrik” sh.p.k. dhe “KESH” sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

NDREQJE GABIMI

Në Fletoren Zyrtare nr.113, në kapak mungon titulli i vendimit nr.697, datë 11.10.2006.

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-eksponatës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006).....	1500
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1300
4. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500

Botime të reja

1 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
2 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
3 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
4 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
5 PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDERKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
6 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
7 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET.....	500
8 PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006).....	1000
9 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQERITË TREGTARE.....	500

Hyri në shtyp më 16 .11.2006
Doli nga shtypi më 20.11.2006

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Ilar"
Tiranë, 2006

Çmimi 150 lekë